



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1943/ 6 prot.

Datë 13/08/2024

V E N D I M
Nr. 1044/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13/08/2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. *REF-12731-07-10-2024*, me objekt “*Ndërtimi i pritave në bregun e lumit Devoll, në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësore, Bashkia Gramsh*”, me fond limit 82,035,740 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 29.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.

Ankimues: Operatori ekonomik “*B93 IP*” SHPK me NIPT: L522090500 dhe me adresë: *Rruga "Margarita Tutulani", pallati "Kaso", Apartamenti nr.76, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Gramsh
Adresa: Bulevardi "10 korriku", Gramsh.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë

13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar,.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11.07.2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-12731-07-10-2024, me objekt “Ndërtimi i pritave në bregun e lumit Devoll, në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësore, Bashkia Gramsh”, me fond limit 82,035,740 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 29.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh.

II.2. Në datën 16.07.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4331 datë 16.07.2024, dhe me nr. 1943/2024 prot, datë 16.07.2024, e operatorit ekonomik “B93 IP” SHPK, me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën nr. 3062/3 prot., datë 22.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 1943/2 prot datë 22.07.2024, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “B93 IP” SHPK.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor me anë të shkresës nr. 3062/3 prot., datë 22.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 1943/2 prot datë 22.07.2024, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “B93 IP” SHPK ku ka vendosur që të mos pranojë ankesën e paraqitur.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “B93 IP” SHPK ku kërkon: “**Pretendimi 1 i OE ANKIMUES**”

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknikë licencën e shoqërisë ofertuese, si më poshtë: -
Inxhinier Hidroteknik - 1 (një)

- *Inxhinier Ndërtimi - 1 (një)*

- *Inxhinier Ndërtimi (Profili Gjeoteknik) - 1 (një)*

- *Inxhinier Topograf - 1 (një)*

*Kërkohet nga Autoriteti Kontraktor prania Drejtues Teknike në licensën e shoqërisë **Inxhinier Ndërtimi Profili Gjeoteknike.***

*Ju bëjmë me dije se **Profili Gjeoteknike i Inxhinierit të Ndërtimit sipas VKM Nr.42 Dt.16.01.2008** nuk është në listën e inxhinierëve të kërkuar për licensimin e shoqërisë në fushën*

e zbatimit të punimeve. Profili Gjeoteknik është një profil i ri i hapur nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit me individë të diplomuar për herë të parë në vitin 2011. Rregullorja e licensimit të shoqërive në fushën e zbatimit, Lidhja 5 përcakton qartësisht profilet e Inxhinierisë së Ndërtimit me anë të të cilëve licensohen shoqëritë në fushën e zbatimit të cilat janë si më poshtë vijon:

- Ndërtim para vitit 1971
- Qytetare Industriale
- Civile Industriale
- Përgjithshëm
- Strukturist
- Transport e Infrastrukturë
- Civile Industriale Ura
- Rruga Ura
- Rruga Ura e Vepra nëntokësore
- Hidroteknik
- Hidroteknik Rruga Ura
- Gjeodezi
- Mjedis
- Arkitekturë para viteve 85

Kërkojmë që ky kriter i veçantë kualifikimi të hiqet nga Autoriteti Kontraktor pasi bie ndesh me rregullat e Prokurimit Publik dhe VKM Nr.42 Dt.16.01.2008.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “**FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**” “**Kriteret e veçanta të kualifikimit**”, pika 2.3.3 “**Aftësitë teknike dhe profesionale**”, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si vijon:

“2.3.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt i Lotit që prokurohet, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturas dhe Energjise, ne baze të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

N.P. -1 B Punime gërmimi në tokë.

N.P - 9 C Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime.

Për punimet speciale të ndërtimit:

N.S.-18B Punime topogjeodezike.

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zerave të preventivit që ne baze të marrëveshjes së bashkëpunimit merr persiper të realizojë.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjise, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja në këto forme është kusht skualifikues.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, **drejtues tekniknë licencën e shoqërisë ofertuese**, si më poshtë:

- Inxhinier Hidroteknik - 1 (një)
- Inxhinier Ndërtimi - 1 (një)
- Inxhinier Ndërtimi (Profili Gjeoteknik) - 1 (një)
- Inxhinier Topograf - 1 (një)

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:

- Kontratat e punës individuale, të vlefshme.
- Diplomën përkatëse.
- Libreze pune.
- Të paraqiten listpagesat e E-Sig të shoqërisë minimalisht të 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipër duhet të figurojnë .
- Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohen papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit, për sa i takon ndalimeve të dypunësimit.
- Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet të paraqesë inxhinieret e mesipër, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”.

III.1.2. Në procesverbalin “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM ” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e këtij kriteri kualifikues si më poshtë:

“Për kriterin 2.3.2.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1/a, 2 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”i ndryshuar, në të cilët përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;... 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme

njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” si dhe nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilët përcaktohet se: “6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”; Gjithashtu bazuar dhe në VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2 dhe 4).

Konkretisht:

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve dhe vlerën e përllogaritur të kontratës.

N.P.– 1Kategoria B“Punime gërmimi në tokë”.(21 – 50 milion leke)

Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv.

N.P. – 9 Kategoria C“Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime”.(51 – 100 milion leke)

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose në rrjet, si do që të jenë realizuar, të nevojshëm për sistemimin e rrjedhjes së ujërave natyrale ose artificiale si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, të kompletuara me punimet lidhëse të nevojshme.

*Përfshin në mënyrë të thjeshtuar kanale lundruese, grykëderdhjet e lumenjve, **konsolidimin e strukturave të anëve të lumenjve dhe përrenjve, argjinatura të llojeve të ndryshme, sistemimin dhe vendosjen e regjimit hidraulik të ujërave sipërfaqësore të veprave të diafragmave të argjinaturave dhe qëndrueshmërisë së shpateve.***

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv.

N.S. - 18 Kategoria B“Punime topogjeodezike”.(21 - 50 milion leke)

Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh

Kjo kategori licence i referohet punimeve topografike të parashikuara në projekt.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</i>	<i>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>	<i>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive</i>
----------------------------	---	---	--

N.P - 1	Punime gërmimi + sistemimi në tokë	Punime gërmim dheu	B
N.P - 9	Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime	Gabion me rrjete teli të zinguar dhe beton.	C
N.S - 18	Punimetopogjeodezike	Zbatimiirilevimevetopografike, punimevetopogjeodezikeetj.	B

Për kriterin 2.3.3.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, kupërcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”, nenit 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6/c dhe c të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se : Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: .. c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose .. c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; si dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar.

Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt, duhet të jenë të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jenë të angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në VKM-ne Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohen papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit, konkretisht: Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “Elementët e licensës” germa “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën Profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Ne mbrojtjet lumore, si pasoje e kushteve klimaterike terreni eshte ne

ndryshim te vazhdueshem,si dhe referuar zerave te preventivit,rezulton se është e domosdoshme që çdo ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë Ndertimi, Hidroteknik, Topograf, dhe Gjeoteknik. Nderkohe qeInxh Mjedisit eshte i domosdoshem ne kete prokurim per arsye se te dyja krahet e lumit ku do te zhvillohet mbrojtja prej nje gjatesie 1 km jane te populluara. Inxh i Mjedisit duhet per garantimin e cilesise se punimeve ne perputhje me kerkesat e mjedisit pereth ne menyre qe punimet te mos shkaktojne ndikim ne mjedis. Qëndrueshmëria e tij në punë me kohështrirje per periudhen e 3 muajve te fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.”.

III.1.3. Lidhur me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “B93 IP” SHPK” ShPK autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes nr. 3062/3 prot., datë 22.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 1943/2 prot datë 22.07.2024, drejtuar ankimuesit ka argumentuar si në vijim: “... Referuar pretendimit të ankimuesit që kjo degë ka individë të diplomuar për herë të parë në vitin 2011, pra më vonë se data e hartimit të VKM nr.42 datë 16.01.2008, ju bëjmë me dije se: Në lidhjen 5 të Aneksit të VKM nr.42 dt.16.01.2008 thuhet se:
Arsimet universitare përkatëse që duhet të ketë drejtuesi/it teknik janë:

<i>Nr</i>	<i>Titulli i diplomës Universitare</i>	<i>Dega</i>
1		<i>Ndërtim para vitit 1971</i>
2		<i>Qytetare Industriale</i>
3		<i>Civile Industriale</i>
4		<i>Përgjithshëm</i>
5		<i>Strukturist</i>
6		<i>Transport e Infrastrukturë</i>
7	<i>Ndërtim</i>	<i>Civile Industriale Ura</i>
8		<i>Rruga Ura</i>
9		<i>Rruga Ura e Vepra nëntokësore</i>
10		<i>Hidroteknik</i>
11		<i>Hidroteknik Rruga Ura</i>
12		<i>Gjeodezi</i>
13		<i>Mjedis</i>
14		<i>Arkitekturë para viteve 85</i>
15	<i>Mekanik</i>	<i>Degë të Inxhinierisë mekanikë</i>
16	<i>Elektrik</i>	<i>Degë të Inxhinierisë elektrike</i>
17	<i>Gjeologji</i>	<i>Gjeolog</i>
18		<i>Markshajder</i>

Që nga koha e hartimit të VKM m.42 dt. 16.01.2008 deri në ditët e sotme në fakultetet përkatëse janë krijuar degë të reja, me profile të reja siç është dhe Inxhinieri i Ndërtimit, Profili Gjeoteknik, dhe shumë degë të tjera. Më poshtë po ju listojmë Programet Master të Universiteteve që përmenden në Lidhjen 5 të VKM nr.42 dt. 16.01.2008.

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit

"Bachelor"

- Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi;
- Bachelor në Inxhinieri Mjedisi;
- Bachelor në Inxhinieri Gjeodezi;
- Bachelor në Inxhinieri Hidroteknike;

"Master i Shkencave"

- Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, profili Strukturist;
- Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, **profili Gjeoteknike**;
- Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi, profili infrastrukturë e Transportit;
- Masteri Shkencave në Inxhinieri Mjedisi profili Trajtim Ujit
- Masteri Shkencave në Inxhinieri Mjedisi, profili Energjetikë;
- Masteri Shkencave në Inxhinieri Hidroteknike,
- Master i Shkencave në Inxhinieri Gjeodezi;

"Master Profesional"

- Master Profesional në Inxhinieri Gjeodezi;
- Master Profesional në Inxhinieri Mjedisi:
- Master Profesional në Inxhinieri Hidroteknike

Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave

Programet e Studimit Master

Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave ofron programet e studimit në nivel "Master".

- **DIPLOME NË MASTER PROFESIONAL**
- Inxhinieri Gjeologjike
- Inxhinieri Gjeomjedisi
- Gjeomatikë
- Inxhinieri Minerare
- Pasurimi i Mineraleve dhe Riciklimi i Mbetjeve
- Inxhinieri e Naftës dhe Gazit
- Gjeologji Inxhinierike dhe Hidrogjeologji
- Vendburimet e Mineraleve të Dobishme-Petrologji
- Gjeologji e Vendburimeve Hidrokarbure
- Inxhinieri e Gjeoinformatike

DIPLOME NË MASTER SHKENCOR

- *Inxhinieri Gjeomjedisi*
- *Inxhinieri Minerare dhe Markshajderi*
- *Pasurim i Mineraleve dhe Ricklimi i Mbetjeve*
- *Inxhinieri e Naftës dhe Gazit*
- *Gjeologji Inxhinierike dhe Hidrogjeologji*
- *Vendburimet e Mineraleve të Dobishme-Petrologji*
- *Gjeologji e Vendburimeve Hidrokarbure*
- *Gjeoinformatike*

PROGRAMET E STUDIMIT PËR CIKLIN E DYTË NË FIE:

1. *Master Shkencor në Inxhinieri Elektrike-Automatizim Industri*
2. *Master Shkencor në Inxhinieri Elektrike-Energjitike*
3. *Master Profesional në Inxhinieri Elektrike-Automatizim Industri*
4. *Master Profesional në Inxhinieri Elektrike-Energjitike*
5. *Master Profesional në Inxhinieri Mekatronike*

SYLABUSET E PROGRAMET E STUDIMIT PËR CIKLIN E DYTË NË FIE:

1. *Sylabuset e Master Shkencor në Inxhinieri Elektrike-Automatizim Industri.*
2. *Sylabuset e Master Shkencor në Inxhinieri Elektrike-Energjitike.*
3. *Sylabuset e Master Profesional në Inxhinier Elektrike-Automatizim Industri.*
4. *Sylabuset e Master Profesional në Inxhinieri Elektrike-Energjitike.*
5. *Sylabuset e Master Profesional në Inxhinieri Mekatronike,*

PROGRAMI I PROVIMIT TË FORMIMIT PËR DIPLOMAT:

1. *Master Profesional në Inxhinieri Elektrike - Automatizim Industri*
2. *Master Profesional në Inxhinieri - Mekatronike*
3. *Master Profesional në Inxhinieri Elektrike - Energjitike*

Programet e Studimit

Arkitekturë Interieri & Design

MSHA-Arkitekt

MSHA-Urbanist

MP- Restaurim Monumentesh Kulturore

Siç shihet nga adresat zyrtare të Fakulteteve të ndryshme rezulton se ka një numër të konsiderueshëm profile të reja që i përshkruajnë kohës, kurrikulave dhe kërkesave të tregut për profesione dhe profilizime të ndryshme.

VKM nr. 42 dt. 16.01.2008 ndër të tjera thotë:

1. Drejtuesi teknik i shoqërisë; a) Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës dhe me përvojë pune jo më pak se 5 vjet nga diplomimi. Për personat që kanë mbaruar universitetin me mesatare note nga 9.0 e lart ose ekuivalent (për studime të përfunduara në shtete të huaja) afati të jetë jo më pak se 3 vjet nga diplomimi.

Pra, këto profesione të reja që plotësojnë kushtin e mësipërm në lidhje me vjetërsinë nga data e diplomimit, nuk mund të pengohet për të qënë pjesë e stafit drejtues Teknik të një shoqërie.

*Fakti që inxhinieri i ndërtimit **profili gjeoteknike** nuk përmendet në VKM nr. 42 dt. 16.01.2008, pasi është degë e krijuar më vonë se hartimi i VKM nr. 42 dt 16.01.2008, nuk do të thotë se ky profil inxhinieri, i dalë nga një fakultet publik shtetëror, i licensuar nga Ministria e Arsimit nuk do mund të punojë në shoqëri zbatimi të punimeve të ndërtimit.*

Marrin dhe një rast tjetër:

Ka disa vite që Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit nuk ka me Inxhinier Mjedisi por e Profilizon në:

- *Inxhinier mjedisi profili trajtim uji*
- *Inxhinier mjedisi profili energjistikë*

Kjo nuk do të thotë se këta inxhinierë nuk mund të jenë drejtues teknik nëpër shoqëri që kanë Licence Zbatimi të Punimeve të Ndërtimit.

Kjo qasje vlen dhe për Fakultetet e tjera të përmendura më sipër. Në rast të ndonjë paqartësie mund ti drejoheni dhe MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, SEKTORIT TË LICENCAVE, i cili licenson Shoqëritë e Zbatimit të Punimeve të Ndërtimit.

*Kërkesa për inxhinier Ndërtimi **Profili Gjeoteknik** është mbështetur dhe në llojin e veprës dhe zërat e punimeve që ka parashikuar projektuesi ku ky Profil Inxhinieri ka për detyrë të ndjekë punime si: **Strukturat mbajtëse të dheut dhe mbrojtëse, pasi vepra jonë është ndërtimi i mureve tërthore (penela) që do të sigurojë mbajtjen e dheut dhe mbrojtjen e tij nga gërryerjet.** Gjithashtu ky profil inxhinieri shërben për kontrollin dhe ndërtimin e themeleve të ndryshme dhe në rastin tonë të gjithë muret tërthore ka themel për të garantuar lidhjen dhe qëndrueshmërinë e murit.*

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron dhe nuk pranohet.“.

III.1.4. Në Nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërsa në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.5. Në Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.1.6. Në nenin 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
- b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose
- c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.

III.1.7. Në KREUN I “QËLLIMI, FUSHA E VEPRIMIT TË RREGULLORES DHE PËRKUFIZIME” pika 1, KREUN III “KATEGORIZIMI DHE KLASIFIKIMI I LICENCËS, ELEMENTET E SAJ, KUSHTET, KRITERET DHE KUFIZIMET” pika 1 dhe pika 2, KREU IV “DREJTUESI TEKNIK I SHOQËRISË DHE PAPAJTUESHMËRIA ME KËTË DETYRË” pika 1/a të VKM Nr. 42 datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregulloreve për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, parashikohet se:

[...]

KREU I

QËLLIMI, FUSHA E VEPRIMIT TË RREGULLORES DHE PËRKUFIZIME

1. Qëllimi dhe fusha e veprimit:

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i organit përgjegjës, procedurave, kriterëve për licencimin profesional për subjektet juridike që kryejnë veprimtari zbatuese ndërtimi, kategorizimi i punimeve për këto subjekte, klasifikimi i tyre, si dhe përcaktimi i të drejtave e përgjegjësive që ka subjekti i pajisur me licencë.

Licencimi, sipas kësaj rregulloreje, është i detyrueshëm për çdo subjekt juridik vendas ose të huaj, që ushtron veprimtari ndërtimore zbatuese në Republikën e Shqipërisë pavarësisht formës së organizimit të tij.

Subjekte private a publike që kryejnë investime në ndërtime me fonde private ose prokurojnë me fonde publike kanë detyrimin për kontraktim vetëm me subjekte të licencuar, sipas kësaj rregulloreje.

KREU III

KATEGORIZIMI DHE KLASIFIKIMI I LICENCËS, ELEMENTET E SAJ, KUSHTET, KRITERET DHE KUFIZIMET

1. Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, garanci

a) Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas:

I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në:

- profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.

II. Klasifikimit të kategorive të përfituara duke u mbështetur në 3 elemente:

- Vlerën e punëve të ngjashme të kryera 4 vitet e fundit si shoqëri;

- Përvojën në punë të individit/ëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë;

- Kapacitetet financiare.

b) Subjektet e licencuara në zbatim nuk mund të kualifikohen si fituese për punë publike të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik nëse janë fitues dhe/apo kanë në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/nëkontraktor një investim sipas një kontrate të lidhur/apo në proces për t'u lidhur sipas ligjit për prokurimin publik me vlerë të përbashkët ose të veçantë që tejkalon vlerën e kategorisë që mban subjekti sipas lidhjes 4. Subjektet e licencuara kanë të drejtë të marrin

pjesë/apo të shpallen fituese në prokurime publike, brenda të njëjtës periudhë deri në vlerën e licencës së përcaktuar sipas lidhjes 4. Në kuptim të kësaj shkronje fjala “periudhë” kupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas ligjit për prokurimin publik nga momenti i shpalljes fitues deri në kolaudim të objektit/investimit. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoritetet kontraktore, sipas ligjit për prokurimin publik, hartojnë dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit në përputhje me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara këtu me detyrimin që kur verifikohet se subjekti përfshihet në investime që tejkalojnë klasën e kategorisë së licencuar sipas lidhjes 4, kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence.

c) Shfuqizuar.

ç) Shfuqizuar.

d) Autoriteti kontraktues kërkon ndërprerjeje e punimeve dhe prishjen e kontratës për çdo vonesë në grafikun e punimeve, që rrezikon përfundimin e punimeve në afatin përfundimtar, të përcaktuar në kontratën e nënshkruar. Në këtë rast edhe për moskryerje të punimeve sipas kushteve të përcaktuara në shkronjën “c” kërkohet heqja e licencës për shoqëri ndërtuese, në përputhje me këtë vendim dhe përjashtimin e saj nga prokurimet publike, në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

2. Elementet e licencës:

a) Licenca përmban këto elemente:

I. Kategoritë e punimeve të ndërtimit (përcaktuar në lidhjen nr.2);

II. Klasifikimin me nivele për çdo kategori (përcaktuar në lidhjen nr.4);

III. Numrin e identifikimit;

IV. Datën e regjistrimit në Regjistrin Themeltar (e njëjtë me datën e marrjes së vendimit nga komisioni);

V. Emrat e drejtuesve ligjorë e teknikë;

VI. Selinë;

6

VII. Afatin e vlefshmërisë;

VIII. Elementet e sigurisë të përcaktuara me urdhër të ministrit;

IX. Të dhënat e plota të kategorive dhe klasifikimit, në pjesën e pasme të licencës (Lidhjet 2 e 4 të kësaj rregulloreje).

b) Formulari i licencës miratohet nga Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës.

LIDHJA 3

Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme

N.P. 1 Punime gjurmimi në tokë

Konsiderohen gjurmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorishte ose shkëmbore.

...

N.P. 9 Punime mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose në rrjet, si do që të jenë realizuar, të

nevojshëm për sistemimin e rrjedhjes së ujërave natyrale ose artificiale si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, të kompletuara me punimet lidhëse të nevojshme. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar kanale lundruese, grykëderdhjet e lumenjve, konsolidimin e strukturave të anëve të lumenjve dhe përrenjve, argjinatura të llojeve të ndryshme, sistemimin dhe vendosjen e regjimit hidraulik të ujërave sipërfaqësore të veprave të diafrangmave të argjinaturave dhe qëndrueshmërisë së shpateve.

...

SHPJEGIME PËR KATEGORITË E NDËRTIMEVE (PUNIMEVE) SPECIALE

...

N.S - 18 Punime topogjeodezike Konsiderohet zbatimi i rëlvimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim 20 të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

KREU IV

DREJTUESI TEKNIK I SHOQËRISË DHE PAPAJTUESHMËRIA ME KËTË DETYRË

1. Drejtuesi teknik i shoqërisë

a) Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr. 5) dhe me përvojë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet pas diplomimit në ciklin e dytë të studimeve universitare. Për personat që kanë mbaruar universitetin me mesatare note nga 9.0 e lart ose ekuivalent (për studime të përfunduara në shtete të huaja) afati të jetë jo më pak se 3 (tre) vjet pas diplomimit në ciklin e dytë të studimeve universitare.”.

Në lidhjen nr. 5 janë përcaktuar llojet e arsimit universitar që duhet të kenë mbaruar individët që do të ushtrojnë detyrën e drejtuesit teknik, si më poshtë:

LIDHJA 5

Nr.	Titulli i diplomës Universitare	Dega
1		Ndërtim para vitit 1971
2		Qytetare Industriale
3		Civile Industriale
4		Përgjithshëm
5		Strukturist
6		Transport e Infrastrukturë
7		Civile Industriale Ura
8	Ndërtim	Rruga Ura
9		Rruga Ura e Vepra nëntokësore
10		Hidroteknik
11		Hidroteknik Rruga Ura
12		Gjeodezi

13		<i>Mjedis</i>
14		<i>Arkitekturë para viteve 85</i>
15	Mekanik	<i>Degë të Inxhinierisë mekanike</i>
16	Elektrik	<i>Degë të inxhinierisë elektrike</i>
17		<i>Gjeolog</i>
18	Gjeologji	<i>Ndërtim miniere</i>
19		<i>Markshajder</i>

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht dëshmi për përvojën e mëparshme. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP-së.

III.1.9. Në kriterin kualifikues të pikës 2.3.3 “*Aftësitë teknike dhe profesionale*”, të Shtojcës 7 “*FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatorët ekonomikë ofertues për të dëshmuar se kanë kapacitetet njerëzore dhe profesionale për të kryer punimet objekt prokurimi, duhet të kenë të punësuar në stafin e tyre në rolin e drejtuesit teknik minimalisht 1 (një) inxhinier ndërtimi i cili të ketë mbaruar studimet e ciklit të dytë në profilin “Gjeoteknik”.

Në pretendimin e tij lidhur me këtë kriter kualifikues ankimesi kërkon që të hiqet kërkesa që drejtuesi teknik i shoqërisë të jetë inxhinier ndërtimi me profilin “Gjeoteknik”, duke argumentuar si në vijim: “*Ju bëjmë me dije se Profili Gjeoteknike i Inxhinierit të Ndërtimit sipas VKM Nr.42 Dt.16.01.2008 nuk është në listën e inxhinierëve të kërkuar për licensimin e shoqërisë në fushën e zbatimit të punimeve. Profili Gjeoteknik është një profil i ri i hapur nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit me individë të diplomuar për herë të parë në vitin 2011.*”

Rregullorja e licensimit të shoqërive në fushën e zbatimit, Lidhja 5 përcakton qartësisht profilet e Inxhinierisë së Ndërtimit me anë të të cilëve licensohen shoqëritë në fushën e zbatimit.”.

Lidhur me hartimin e këtij kriteri kualifikues, përsa i përket përkësës që drejtuesi teknik duhet të jetë inxhinier ndërtimi, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ky kriter është në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, pasi kjo kërkesë është hartuar në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik sipas përcaktimeve të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe në përputhje me legjislacioni sektorial sipas përcaktimeve të Kreut I dhe Kreut IV të VKM Nr. 42 datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, ku si një nga kushtet që duhet të plotësojë operatori ekonomik ofertues për t’u kualifikuar dhe për të fituar kontrata publike është pajisja me licensë profesionale për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e zbatimit të punëve civile.

Lidhur me përcaktimin në kriterin kualifikues, përsa i përket kërkesës që drejtuesi teknik duhet të ketë një diplomë universitare të Fakultetit të Ndërtimit në degën “Gjeoteknik” Komisioni konstaton se kjo kërkesë lidhur me profilin “Gjeoteknik” është në kundërshtim me përcaktimet në Lidhjen 5 të të VKM Nr. 42 datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, pasi në këtë lidhje janë përcaktuar degët e Fakultetit të Ndërtimit për të cilat duhet të ketë përfunduar një individ për të plotësuar kushtet për tu licensuar si drejtues teknik pranë një shoqërie që ushtron veprimtarinë në fushën e zbatimit të punëve të ndërtimit, shi dhe kjo kërkesë bie në kundërshtim me përcaktimet e nenit 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi ul konkurrencën duke lejuar pjesmarrjen e operatorëve ekonomik të cilët kanë në licensën e tyre drejtues teknik të cilët disponojnë një diplomë universitare të Fakultetit të Ndërtimit në degën “Gjeoteknik”, ndërkohë që refruar përcaktimeve Lidhjen 5 të të VKM Nr. 42 datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, drejtues teknik mund të licensohen edhe individë të cilët disponojnë një diplomë universitare të Fakultetit të Ndërtimit në degët si në vijim: “Ndërtim para vitit 1971; Qytetare Industriale; Civile Industriale; Përgjithshëm; Strukturist; Transport e Infrastrukturë; Civile Industriale Ura; Rruga Ura; Rruga Ura e Vepra nëntokësore; Hidroteknik; Hidroteknik Rruga Ura dhe Gjeodezi”.

Lidhur me pretendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, i cili në në kthimin e përgjigjes nr. 3062/3 prot., datë 22.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 1943/2 prot datë 22.07.2024, drejtuar ankimesit ka argumentuar si në vijim: “... Kërkesa për inxhinier Ndërtimi **Profili Gjeoteknik** është mbështetur dhe në llojin e veprës dhe zërat e punimeve që ka parashikuar projektuesi ku ky Profil Inxhinieri ka për detyrë të ndjekë punime si: **Strukturat mbajtëse të dheut dhe mbrojtëse, pasi vepra jonë është ndërtimi i mureve tërthore (penela) që do të sigurojë mbajtjen e dheut dhe mbrojtjen e tij nga gërryerjet.** Gjithashtu ky profil inxhinieri

shërben për kontrollin dhe ndërtimin e themeleve të ndryshme dhe në rastin tonë të gjithë muret tërthore ka themel për të garantuar lidhjen dhe qëndrueshmërinë e murit.”, Komisioni konstaton se nuk qëndron, pasi në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.2 “Aftësitë teknike dhe profesionale”, të Shtojcës 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt prokurimi, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategorinë e punimeve N.P – 9 “Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime”, ku referuar LIDHJES 3 të VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, kjo kategori punimesh përfshin: “N.P. 9 Punime mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime. Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose në rrjet, si do që të jenë realizuar, të nevojshëm për sistemimin e rrjedhjes së ujërave natyrale ose artificiale si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, të kompletuara me punimet lidhëse të nevojshme. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar kanale lundruese, grykëderdhjet e lumenjve, konsolidimin e strukturave të anëve të lumenjve dhe përrenjve, argjinatura të llojeve të ndryshme, sistemimin dhe vendosjen e regjimit hidraulik të ujërave sipërfaqësore të veprave të diafrangmave të argjinaturave dhe qëndrueshmërisë së shpatëve.”, pra përse kohë që autoriteti kontraktor ka kërkuar që shoqëria që do të ofertojë në këtë procedurë prokurimi duhet të jetë e licensuar për kategorinë e punimeve “N.P-9” atëherë shoqëria ofruese nuk është e nevojshme që të ketë drejtues teknik një inxhinier ndërtimi me profilin “Gjeoteknik”, por mjafton që kjo shoqëri të jetë e licensuar për kategorinë e punimeve “N.P-9”, çka krijon bindjen dhe sigurinë për autoritetin kontraktor sa ka kapacitetet teknike dhe profesionale për kryerjen e punimeve objekt prokurimi, ku përfshihen dhe punimet; “Strukturat mbajtëse të dheut dhe mbrojtëse”.

Në përfundim Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se pretendimi i ankimesit për kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Aftësitë teknike dhe profesionale”, të Shtojcës 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit, qëndron, pasi kërkesa që drejtuesi teknik i licensës së operatorit ekonomik ofertues është në kundërshtim me përcaktimet e VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, si dhe ul konkurrencën, ndërkohë që kërkesa e përcaktuar në kriterin kualifikues të pikës 2.3.2 “Aftësitë teknike dhe profesionale”, të Shtojcës 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit krijon bindjen dhe sigurinë për autoritetin kontraktor se operatorët ekonomik ofertues që plotësojnë këtë kriter kanë kapacitetet teknike dhe profesionale për kryerjen e punimeve objekt prokurimi ku përfshihet dhe zëri i punimit “Strukturat mbajtëse të dheut dhe mbrojtëse”, prandaj autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për të hequr kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Aftësitë teknike dhe profesionale”, të Shtojcës 7 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “B93 IP” SHPK ku kërkon modifikimin e kritereve kualifikues të përcaktuara në shtojcën 7 “*FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pikat 2.3.4; 2.3.6 dhe 2.3.8 “*Aftësitë teknike dhe profesionale*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 “*FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pikat 2.3.4; 2.3.6 dhe 2.3.8 “*Aftësitë teknike dhe profesionale*”, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si vijon:

[...]

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë *punonjës të specializuar* për kryerjen e punimeve, të cilët duhet të jenë të pajisur me Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “*Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.*”, i ndryshuar, sipas profileve të më poshtëme:

- Teknik Ndërtimi	1 (nje)
- Teknik Gjeolog	1 (nje)
- Teknik Gjeodet/Topograf	1 (nje)
- Teknik Hidroteknik	1 (nje)
- Murator	9 (nente)
- Karpentier	9 (nente)
- Hekurkthyes	3 (tre)
- Hidroizolues	1 (nje)
- Punonjes Guri/Gurepunues	10 (dhjete)

❖ **Shënim:** Gjate fazes së ofertimit, në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8), në pika B. - Deklarata - “*Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate*”, operatorët ekonomik për punonjësit e mesipër **duhet të deklarojnë:** emer/mbiemer, profilin e punës, subjektin leshues të certifikates/diplomes, Nipt (në rastin kur subjekti leshues i certifikates/diplomes është privat).

Diplomat/çertifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislationit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike.

***Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.**

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do të kërkojë ofertuesit të kualifikuar të pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:
Per punonjësit e mesipër duhet të paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.

- *Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh. ”, i ndryshuar.*
- *Të paraqiten listepagesat përkatëse të shoqërisë minimalisht të 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipërm të figurojnë .*
- *Per teknikun e ndertimit, teknikun hidroteknik, teknikun gjeodet, teknikun teknikun gjeolog duhet te paraqitet dhe deftese e shkolles se mesme.*

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperem, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

2.3.6. *Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim jo me pak se 72 (shtatedhjetë e dy) punojesish ne fushen e ndertimit, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimum, 3(tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave e vërtetuar me:*

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar.*
- Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar.*

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.*

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumentacionit të lartpërmendur.

2.3.8. *Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:*

Makineri dhe pajisje	Nr.	Njesia	Gjendja
<i>Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 10-12 t</i>	<i>3</i>	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes jo me te vogel 20 t</i>	<i>5</i>	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Kamioncine me kapacitet mbajtes deri ne 1.5-3.5 t</i>	<i>3</i>	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Kamion me vinc</i>	<i>2</i>	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Eskavator me Goma (mjet teknologjik me goma)</i>	<i>3</i>	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Eskavator me zinxhir me krah jo me pak se 18 m</i>	<i>2</i>	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Fadrome (mjet teknologjik me goma)</i>	<i>1</i>	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Dumper (mjet teknologjik me goma)</i>	<i>2</i>	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Grejder (mjet teknologjik me goma)</i>	<i>1</i>	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Rul ngjeshes me vibrim mbi 15t</i>	<i>2</i>	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Autovinc</i>	<i>1</i>	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Autobetoniere me kapacitet 2.5 - 3 m3</i>	<i>2</i>	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Autobot uji</i>	<i>2</i>	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>

<i>Autobetoniere</i>	4	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Autopompe Betoni</i>	2	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>RTV - Transportier per mjete te renda</i>	2	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Agregat per prerje bimesie</i>	1	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Moto gjenerator</i>	2	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Betoniere kantieri</i>	3	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Vibrues betoni</i>	5	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Karoca dore</i>	6	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Moto pompe uji</i>	2	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Kethyese hekuri / bango hekuri</i>	1	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>G.P.S</i>	1	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Total Station</i>	1	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Kokore</i>	72	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Jelek</i>	72	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Tabela sinjalizuese kantieri</i>	4	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Komplet i ndihmes se shpejte</i>	2	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Ëellpoint</i>	1	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Armaturë/betoforma/lendë drusore</i>	500	<i>M2</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Impiant prodhim betoni me QKL</i>	1	<i>cope</i>	<i>Nëpronësi, me qera, osekontratëfurnizimi</i>
<i>Nyje Inerte</i>	1	<i>cope</i>	<i>Nëpronësi, me qera, osekontratëfurnizimi</i>

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.*

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:

a) Për mjetet në pronësi, që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

1. *Dokument qe verteton pronesine e mjetit.*
2. *Leje qarkullimi (e vlefshme)*
3. *Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)*
4. *Police sigurimi (e vlefshme)*
5. *Leje transporti, leshuar nga pushteti vendor (e vlefshme)*

b) Për mjetet e marra me qera, që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

1. *Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj (e vlefshme).*
2. *Leje qarkullimi (e vlefshme)*
3. *Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)*
4. *Police sigurimi (e vlefshme)*

5. *Leje transporti per vete dhe te trete (leshuar nga pushteti vendor e vlefshme)*

- c) *Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjete dhe targa e tij.*
- d) *Operatori ekonomik duhet të deklarojë vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me anë të një deklarate të firmosur dhe vulosur nga Administratori, me qëllim të verifikimit nga Autoriteti Kontraktor*

Ne rast se operatori ekonomik nuk disponon mjet RTV – Transportues për mjetet e renda mund të paraqesë kontratë bashkëpunimi të vlefshme për gjithë periudhën që zgjasin punimet.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e verifikimit të saktësisë së informacionit. Mos dorëzimi i informacionit të saktë apo të rremë do të konsiderohet kusht për skualifikim dhe/ose fillim i hetimit administrativ për përjashtim të Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

III.2.2. Në procesverbalin “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” të publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronik, autoriteti kontraktor ka argumentuar vendosjen e kriterëve kualifikuesë të sipërpërmendura, si më poshtë:

“Për kriterin 2.3.4.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”, nenit 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6/c dhe c dhe 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” ndër të tjerash përcaktohet se : Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: .. b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose .. c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; 8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar, si dhe referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjetikës dhe referuar Kodit Rrugor.*

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas specifikimeve teknike (të cilat do publikohen së bashku me dokumentat e tenderit) Punetoret e specializuar në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punës që do të realizohen si dhe kohëzgjatjen e tyre. Specialistet Muratore dhe Karpentiere, dhe specialiste guri janë te domosdoshem pasi zeri kryesor i këtij prokurimi janë profilat mbrojtës mbushur me gure kave si dhe blloqet e betonit. Nga zberthimi i zerave te preventivit lidhur me grafikun e punimeve del se duhen me patjeter numuri i kerkuar i ketyre punojesve. Manovraret, automakinistet dhe shoferet gjithashtu zene nje vend te rendesishem ne kete procedure pasi nga zberthimi i zerave te preventivit lidhur me grafikun e punimeve dhe me zberthimin e punimeve sipas analizave perkatese del.

*Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike. Kërkesa që certifikimet e punojesve të deklarohen që në fazën e ofertimit behet per arsye qe Autoriteti Kontraktor te kete mundesi verifikimi per deklarimet e bera nga Operaret ofertues ne menyre qe te mos krijohen vonesa ne procesin e shpalljes se operatorit fitues pasi keto investime jane emergjente dhe kane domosdoshmeri nisjen sa me pare te punimeve. Per me teper, qëllimi i paraqitjes së deklaratës “Mbi disponimin e punonjësve të nevojshëm” në këtë shtojcë, është garantimi i ekzekutimit të kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, pra që operatori ekonomik ka stafin teknik sipas të dhënave të kërkuara. Referuar sa më sipër, plotësimi i kësaj deklaratë do të jetë në lidhje me numrin e punonjësve dhe profilin e tyre sipas kërkesave specifike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të një procedure prokurimi. Njesia e Prokurimit në kuptim të fjalës **“duhet të deklarojë”** percakton se ky deklarim është pjesë e dokumentave standarte të tenderit dhe si i tillë duhet të plotësohet nga OE ofertues. Kjo kërkesë nuk sjell kufizim të pjesëmarrjes së operatoreve ekonomik në tender, kosto të shtuar për ta si dhe konfuzion në OE ofertues, pasi informacioni i kërkuar është pjesë e dosjes së secilit prej punojesve.*

Për kriterin 2.3.6.

Argumentimi: *Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”. Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Nga zberthimi i zerave te preventivit rezulton se per realizimin e kontrates Brenda grafikut nevojiten rreth 72 punonjes duke perfshire staf tekni, specialiste etj. Duke qene se OE mund te punoje dhe ditet pushim si dhe me orare te zgjatura Brenda percaktimeve ligjore NJP ka kerkuar nje numur me te vogel punojesish kjo dhe per te*

nxitur garen. Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetime të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në kreun V, seksioni III, neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Për kriterin 2.3.8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe kreut V, seksioni III, neni 39, pika 6, germa “d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nëpërmjet këtyre kërkesave, operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objektit mundësive të manovrimit me mjete të rënda, urbanizimit për efekt të zhurmave dhe ndotjes etj. Nga zberthimit i zerave të preventivit konkretisht rezulton se janë një sasi e konsiderueshme inerte dhe gure për tu zhvendosur dhe për tu sjelle në kantier. Nderkohe që rezulton se nevojiten për realizimin e kontratës rreth 1140 ore pune me mjete të rënda

(eskavator, skrep, fadrome, rul etj) Kërkesa për mjete të renda specifike si eskavatore krahegjate, nevojitet si shkak i gjerësisë tepër të madhe të lumit në pjesën ku do të zhvillohet mbrojtja cka krijon problematika në devijimin e lumit si dhe thellesisë në pjesën ku do të zhvillohet mbrojtja si shkak i gjerësisë së vazhdueshme. Sasia e mjeteve/makinerve që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

III.2.3. Lidhur me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues “B93 IF” SHPK” ShPK autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes nr. 3062/3 prot., datë 22.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 1943/2 prot datë 22.07.2024, drejtuar ankimuesit ka argumentuar si në vijim:

[...]

I. Lidhur me pikën e dytë të ankesës (pretendimet e ankuesit):

Operatori ekonomik ankimues ka bërë bërthimin e analizave të Manualit Teknik sipas VKM nr.216 datë 13.04.2023, për të gjithë zërat në Preventiv, ku ndër të tjera ka argumentuar se:

A 3.331 Gabion me rrjet teli xingato 1x1x1 4000 m3

Zërat e kërkuar për këtë zë punimesh përmblihen si më poshtë vijon:

Sp + p: op 5.6

Gur kave m3: 1.01

Rrjete gabian zingat m2: 6.2

Hekur 6 kg: 2.7

Tel zingato kg: 0.55

Për afat realizimi 5 muaj (vlerësuar 110 ditë pune) sipas autoritetit kontraktor i korrespondon

Fuqi Punëtore: 25 punonjës

B. 3.332 Gabion me rrjet teli xingato 1x1x1.5 3200 m3

Zërat e kërkuar për këtë zë punimesh përmblihen si më poshtë vijon:

Sp + p op: 5.3

Gur kave m3: 1.01

Rrjete gabian zingat m2: 6.2

Hekur 6 kg: 2.7

Tel zingato kg 0.55

Për afat realizimi 5 muaj (Vlerësuar 110 ditë pune) sipas autoritetit kontraktor i korrespondon

Fuqi Punëtore: 19 punonjës

C. 3.333 Gabion me rrjet teli xingato 1x1x2 2100 m3

Zërat e kërkuar për këtë zë punimesh përmblihen si më poshtë vijon:

Sp + p op: 5.1

Gur kave m3: 1.01

Rrjete gabian zingat m2: 5.2

Hekur 6 kg: 225

Tel zingato kg: 0.45

*Për afat realizimi 5 muaj (vlerësuar 110 diteë pune) sipas autoritetit kontraktor i korrespondon
Fuqi Punëtore: 12 punonjës*

Shtresë betoni C16/20 t=15cm 345 m3

Sp + p op: 12.8

Betonjere 500 liter op: 0.65

Vibrator thellësie op: 1.64

Çimento 32.5 Nkg: 274

Zall i larë lavatrice m3: 0.79

Rere e lare m30.46

Kallëpe m2: 5.4

Për afat realizimi 5 muaj (vlerësuar 110 ditë pune) sipas autoritetit kontraktor i korrespondon

Fuqi Punëtore: 5 punonjës

Shtrese betoni C16/20 t=15cm 445 m3

Sp + p op: 12.8

Betonjere 500 liter op: 0.65

Vibrator thellësie op: 1.64

Çimento 32.5 N kg: 274

Zall i larë lavatrice m3: 0.79

Rërë e larë m3: 0.46

Kallëpe m2: 5.4

Për 5 muaj (vlerësuar 110 ditë pune) sipas autoritetit kontraktor i korrespondon

Fuqi Punëtore: 6 punonjës

Mbjellje pemë rrapi 360 copë

Sp + p op: 1.00

Për afat realizimi 5 muaj (vlerësuar 110 ditë pune) sipas autoritetit kontraktor i korrespondon

Fuqi Punëtore: 1 punonjës

Pasi ka bërë zbërthimin e Manualit për zërat përkates operatori ekonomik kërkon:

Në mënyrë të permbledhur, sipas zbërthimit të preventivit të punimeve dhe analizave përkatëse rezultone kërkesat si më poshtë në lidhje me fuqinë punëtore dhe makineritë:

Fuqi Punëtore 68 punonjës

Po të mbledhësh fuqinë punëtore të nxjerrë nga vet operatori ankimues kemi numrin e punëtorëve:

25+19+12+5+6+1=68 punonjës.

Por, referuar Manualit Teknik sipas VKM nr.216 datë 13.04.2023 për 2 zëra punimesh kemi analizat si më poshtë dhe jo ato të nxjerra nga operatori ankimues:

Shtrese betoni C16/20 t=15cm 345 m3

<i>Nr.</i>	<i>Nr</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Tipi</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>
		<i>manual</i>			

1	√	Transport auto mbi 10 km	TRANSPORT	t/km	12.48
2	√	Vinc kulle 4-6 T me manovrator	MAKINERI DHE PAJISJE	cp	0.73
3	√	Beton C-16/20 (Me zall)	MATERIAL	m3	1.04
4	√	SP+P (paga bruto + kontributet)	PUNTORI	op	8.6

Për afat realizimi 5 muaj (vlerësuar 110 ditë pune) sipas autoritetit kontraktor i korrespondon Fuqi Punëtore: 3 punonjës dhe jo 5 (sipas operatorit ekonomik ankimes)

Shtrese betoni C16/20 t=15cm 345 m3

Nr.	Nr manual	Emërtimi	Tipi	Njësia	Sasia
1	√	Transport auto mbi 10 km	TRANSPORT	t/km	12.48
2	√	Vinc kulle 4-6 T me manovrator	MAKINERI DHE PAJISJE	cp	0.73
3	√	Beton C-16/20 (Me zall)	MATERIAL	m3	1.04
4	√	SP+P (paga bruto + kontributet)	PUNTORI	op	8.6

Për afat realizimi 5 muaj (vlerësuar 110 ditë pune) sipas autoritetit kontraktor i korrespondon Fuqi Punëtore: 4 punonjës dhe jo 5 (sipas operatorit ekonomik ankimes)

Pra në total kemi: 25+19+12+3+4+1= 64 Punonjës

Shtojmë Drejtuesit Teknik = 4 Punonjës

Shtojmë Stafin mbështetës = 1 Punonjës

Shtojmë Teknikët e Mesëm = 3 Punonjës

Në Total kemi = 72 Punonjës

Numër ky që përputhet dhe me numrin e punonjësve të kërkuar në pikën 2.3.6 të DST.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim jo më pak se 72 (shtatëdhjetë e dy) punonjësish në fushën e ndërtimit, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimum, 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave e veërtetuar me:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar.
2. Listpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron dhe nuk pranohet.

III. Lidhur me pikën e tretë të ankesës (pretendimet e ankuesit):

Operatori ekonomik ankimes në ankesën e paraqitur kërkon:

Hidroizolues 1: Në asnjë zë të preventivit dhe projektit nuk parashikohen punime hidroizolimi, prandaj duhet të hiqet si kriter punimesh.

Në shtojcën e nxjerrë nga Autoriteti Kontraktor të nxjerrë në datën 15.07.2024 mbi ndryshimet e Dokumentave të Tenderit ndër të tjera thuhet:

ISHTE

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar** për kryerjen e punimeve, te cilet duhet te jene te pajisur me Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar, sipas profileve te më poshtëme:

- Teknik Ndërtimi	1 (nje)
- Teknik Gjeolog	1 (nje)
- Teknik Gjeodet/Topograf	1 (nje)
- Teknik Hidroteknik	1 (nje)
- Murator	9 (nente)
- Karpentier	9 (nente)
- Hekurkthyes	3 (tre)
- Hidroizolues	1 (nje)
- Punonjes Guri/Gurepunues	10 (dhjete)

❖ **Shënim:** Gjate fazes se ofertimit, në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8), ne pika B. - Deklarata - “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik per punonjesit e mesiperm **duhet të deklarojnë:** emer/mbiemer, profilin e punes, subjektin leshues te certifikates/diplomes, Nipt (ne rastin kur subjekti leshues i certifikates/diplomes eshte privat).

Diplomat/çertifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike.

***Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.** Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtem:

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar.
- Të paraqiten listepagesat përkatëse të shoqërisë minimalisht të 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipërm të figurojnë .
- Per teknikun e ndertimit, teknikun hidroteknik, teknikun gjeodet, teknikun teknikon gjeolog duhet te paraqitet dhe deftese e shkolles se mesme.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

BËHET

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar** për kryerjen e punimeve, te cilet duhet te jene te pajisur me Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar, sipas profileve te më poshtëme:

- Teknik Ndërtimi	1 (nje)
- Teknik Gjeodet/Topograf	1 (nje)
- Teknik Hidroteknik	1 (nje)
- Murator	9 (nente)
- Karpentier	9 (nente)
- Hekurkthyes	3 (tre)
- Punonjes Guri/Gurepunues	10 (dhjete)

- ❖ **Shenim:** Gjate fazes se ofertimit, në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8), ne pika B. - Deklarata - “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik per punonjesit e mesiperm **duhet të deklarojnë:** emer/mbiemer, profilin e punes, subjektin leshues te certefikates/diplomes, Nipt (ne rastin kur subjekti leshues i certifikates/diplomes eshte privat).

Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtem:

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar.
- Të paraqiten listepagesat përkatëse të shoqërisë minimalisht të 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipërm të figurojnë .
- Per teknikun e ndertimit, teknikun hidroteknik, teknikun gjeodet, teknikun teknikun gjeolog duhet te paraqitet dhe deftese e shkolles se mesme.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperem, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Pra kërkesa për HIDROIZOLUES është hequr dhe ky pretendim i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron, pasi kjo kërkesë është hequr, dhe përpara hartimit të ankesës, operatori duhet të kishte lexuar dhe ndryshimet në Dokumentat Standarte të Tenderit të reflektuara me Shtojcën datës 15.07.2024.

IV. Lidhur me pikën e katërt të ankesës (pretendimet e ankuesit):

Operatori ekonomik ankimues në ankesën e paraqitur kërkon:

Murator 9: Në asnjë zë të preventivit nuk parashikohen punime muri prandaj duhet të hiqet si kriter punimesh Punonjës Guri/Gurëpunues: Në asnjë zë të preventivit nuk parashikohen punime guri prandaj duhet të hiqet si kriter punimesh

Referuar Preventivit të Punimeve dhe projektit si më poshtë kemi:

PREVENTIV
OBJEKTI: NDERTIM PRITA PER MBROJTJEN NGA LUMI DEVOLL

Nr	Shenja Manualit	Pershkrimi i punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Shuma
1	3.101.b	Germim themeli me makineri 0.5 m3 B>2m shkarkime ne toke	m3	6600		
2	3.331	Gabiona rrjett xingato 1x1x1	m3	4000		
3	3.332	Gabiona rrjet xingato 1x1x1.5	m3	3200		
4	3.333	Gabiona rrjet xingato 1x1x2	m3	2100		
5	1.262/4	Shtrese betoni C-16/20 t=15cm	m3	345		
		SHUMA I				
		II.SISTEMIMI I PERRENJEVE				
1	3. 101/b	Gerniün rnakineri 0.5m3 b>2	m3	3800		
2	1.262/4	Shtrese betoni C-16/20 t=15cm	m3	445		
		SHUMA II				
		III. MBJELLJE PEMESH RRAPI				
1	3.101/b	Germim gropa makineri	m3	360		
2	3.966	Mbjellje peme Rrapi (16 - 18) cm, h>2.5m	cope	360		
		SHUMA III				
		SHUMA I+II+III pa tvsh				0
		T.V.SH		20%		0
		SHUMA TOTAL				0

Gabiona rrejt xingato 1x1x1 = 4000 m3

Gabiona rrejt xingato 1x1x1.5 = 3200 m³

Gabiona rrejt xingato 1x1x2 = 2100 m³

Kodi	Emërtimi	Njësia			
3.331	Gabiona rrjett xingato 1x1x1 m	m ³			
Përbërësit e analizës					
<i>Nr.</i>	<i>Nr manual</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Tipi</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>
1	√	SP+P (paga bruto + kontributet)	PUNTORI	op	5.6
2	√	Gure kave	MATERIAL	m ³	1.01
3	√	Rrjete gabion zinkat	MATERIAL	m ³	6.2
4	√	Hekur betoni zakonshëm Ø 6-10 mm ²	MATERIAL	kg	2.7
5	√	Tel zinku	MATERIAL	kg	0.55

Kodi	Emërtimi	Njësia			
3.332	Gabiona rrjett xingato 1x1x1.5 m	m ³			
Përbërësit e analizës					
<i>Nr.</i>	<i>Nr manual</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Tipi</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>
1	√	SP+P (paga bruto + kontributet)	PUNTORI	op	5.3
2	√	Gure kave	MATERIAL	m ³	1.01
3	√	Rrjete gabion zinkat	MATERIAL	m ³	6.2
4	√	Hekur betoni zakonshëm Ø 6-10 mm ²	MATERIAL	kg	2.7
5	√	Tel zinku	MATERIAL	kg	0.55

Kodi	Emërtimi	Njësia			
3.333	Gabiona rrjett xingato 1x1x2 m	m ³			
Përbërësit e analizës					
<i>Nr.</i>	<i>Nr manual</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Tipi</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>
1	√	SP+P (paga bruto + kontributet)	PUNTORI	op	5.1
2	√	Gure kave	MATERIAL	m ³	1.01
3	√	Rrjete gabion zinkat	MATERIAL	m ³	5.2
4	√	Hekur betoni zakonshëm Ø 6-10 mm ²	MATERIAL	kg	2.25
5	√	Tel zinku	MATERIAL	kg	0.45

Referuar Analizave të Manualit Teknik në fuqi zërat e punimeve Gabion kanë nënzërat e mësipërme, ku njëri nga elementët kryesorë është GURI KAVE (që nënkupton gur të nxjerrë nga karrierat, me shpërthime apo me metoda të ndryshme, gur ky që vjen në forma dhe madhësi të ndryshme, që duhet të përshtaten për ndërtimin e Pritave apo Penelave në lumë, sipas vizatimeve teknike në projekt).

Fig nr 1 (shembull i një Mbrojtje me Gabion, Foto e marrë nga Interneti)

Referuar kurrikulave të formimit profesional apo të formimit të specialiteteve të ndryshme në fushën e ndërtimit Muratori i realizon punimet si më poshtë:

Ndërtim mur guri e butobeton, me tulla e bloqe, mure me shtresë termoizoluese, me tulla xhami, me gur natyror në të thatë, si dhe mure me gabiona.

Përgatitjen dhe punimin e gurit në forma dhe madhësi të lejueshme për tu vendosur brenda në koshat me rrjete të gabionave e realizon - Punonjës Guri/Gurëpunues

Sa më sipër pretendimet e Operatorit Ekonomik Ankimues për specialistët e mësipërm nuk qëndrojnë.

V. Lidhur me pikën e pestë te ankeses (pretendimet e ankuesit):

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar gjithashtu zërat si më poshtë vijon:

- Teknik Ndërtimi 1 (një)
- Teknik Gjeolog 1 (një)
- Teknik Gjeodet/Topograf 1 (një)
- Teknik Hidroteknik 1 (një)

Por në të njëjtën kohë ka kërkuar dhe për secilin prej tyre inxhinierët përkatës

- Inxhinier Hidroteknik - 1 (një)
- Inxhinier Ndërtimi - 1 (një)
- Inxhinier Ndërtimi (Profili Gjeoteknik) - 1 (një)
- Inxhinier Topograf - 1 (një)
- Inxhinier Mjedisi - 1 (një)
- Inxhinier Gjeolog - 1 (një)

Duket e panevojshme prania e secilit teknik krahas çdo inxhinieri ndërtimit. Autoriteti kontraktor të vërë njëvlefshmërinë me titullin inxhinier për profilet teknik të mësipërm mqs e mbulon dhe tejkalon arsimimet e mësipërme të individëve.

Referuar ankesës së operatorit ekonomik në datë 16.07.2024 arsyetojmë se pretendimi i mësipërm nuk vlen, pasi në shtojcën e nxjerrë nga Autoriteti Kontraktor të nxjerre në datën 15.07.2024 (shtojcë e nxjerrë përpara hartimit të ankesës nga operatori) mbi ndryshimet e Dokumentave të Tenderit ndër të tjera thuhet:

ISHTE

2.3.3/1 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier Mjedisi - 1 (nje)
- **Inxhinier Gjeolog** - 1 (nje)

Nese operatori ekonomik ofertues nuk disponon nje Inxhinier Mjedisi mund të paraqesë një kontratë me persona apo subjekte të cilët kryejnë shërbime të specializuara në fushën e kerkuar,

jashtë ndërmarrjes, e cila duhet të ketë kohëzgjatje për të mbuluar të gjithë periudhën e ofrimit të shërbimeve që janë objekt i këtij prokurimi si dhe te plotesoje kërkesat e mesiperme.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:

- Kontratat e punës individuale, të vlefshme.
- Diplomën përkatëse.
- Libreze pune.
- Të paraqiten listpagesat e E-Sig të shoqërisë minimalisht të 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipër duhet të figurojnë .

BËHET

2.3.3/1 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- | | |
|---------------------|-----------|
| - Inxhinier Mjedisi | - 1 (nje) |
|---------------------|-----------|

Nese operatori ekonomik ofertues nuk disponon nje Inxhinier Mjedisi mund të paraqesë një kontratë me persona apo subjekte të cilët kryejnë shërbime të specializuara në fushën e kerkuar, jashtë ndërmarrjes, e cila duhet të ketë kohëzgjatje për të mbuluar të gjithë periudhën e ofrimit të shërbimeve që janë objekt i këtij prokurimi si dhe te plotesoje kërkesat e mesiperme.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:

- Kontratat e punës individuale, të vlefshme.
- Diplomën përkatëse.
- Libreze pune.
- Të paraqiten listpagesat e E-Sig të shoqërisë minimalisht të 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipër duhet të figurojnë .

ISHTE

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar** për kryerjen e punimeve, te cilet duhet te jene te pajisur me Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar, sipas profileve te më poshtëme:

- | | |
|---------------------------|----------------|
| - Teknik Ndërtimi | 1 (nje) |
| - Teknik Gjeolog | 1 (nje) |
| - Teknik Gjeodet/Topograf | 1 (nje) |
| - Teknik Hidroteknik | 1 (nje) |

- | | |
|----------------------------|----------------|
| - Murator | 9 (nente) |
| - Karpentier | 9 (nente) |
| - Hekurkthyes | 3 (tre) |
| - Hidroizolues | 1 (nje) |
| - Punonjes Guri/Gurepunues | 10 (dhjete) |

❖ **Shenim:** Gjate fazes se ofertimit, në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8), ne pika B. - Deklarata - “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik per punonjesit e mesiperm **duhet të deklarojnë:** emer/mbiemer, profilin e punes, subjektin leshues te certifikates/diplomes, Nipt (ne rastin kur subjekti leshues i certifikates/diplomes eshte privat).

Diplomat/çertifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.
Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtem:

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh. ”, i ndryshuar.
- Të paraqiten listepagesat përkatëse të shoqërisë minimalisht të 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipërm të figurojnë .
- Per teknikun e ndertimit, teknikun hidroteknik, teknikun gjeodet, teknikun teknikun gjeolog duhet te paraqitet dhe deftese e shkolles se mesme.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

BËHET

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar** për kryerjen e punimeve, te cilet duhet te jene te pajisur me Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh. ”, i ndryshuar, sipas profileve te më poshtëme:

- | | |
|---------------------------|---------|
| - Teknik Ndërtimi | 1 (nje) |
| - Teknik Gjeodet/Topograf | 1 (nje) |
| - Teknik Hidroteknik | 1 (nje) |

- Murator 9 (nente)
- Karpentier 9 (nente)
- Hekurkthyes 3 (tre)
- Punonjes Guri/Gurepunues 10 (dhjete)

❖ **Shënim:** Gjate fazes se ofertimit, në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8), në pika B. - Deklarata - "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate", operatorët ekonomik për punonjësit e mesiperm **duhet të deklarojnë:** emer/mbiemer, profilin e punes, subjektin leshues të certifikates/diplomes, Nipt (në rastin kur subjekti leshues i certifikates/diplomes është privat).

Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtem:

Per punonjësit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.", i ndryshuar.
- Të paraqiten listepagesat përkatëse të shoqërisë minimalisht të 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punonjësit e mësipërm të figurojnë .
- Per teknikun e ndertimit, teknikun hidroteknik, teknikun gjeodet, teknikun teknikun gjeolog duhet te paraqitet dhe deftese e shkolles se mesme.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punonjësit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Pra, në Shtojcën e nxjerrë nga Autoriteti Kontraktor është hequr **Inxhinieri Gjeolog, Tekniku gjeolog dhe hidroizoluesi**. Operatori ekonomik ankimues përpara hartimit të ankesës duhet ti referohet Dokumentave Standarte Të Tenderit dhe ndryshimeve që ajo ka pësuar (në rastin e procedurës tonë kemi shtojcë në datën 15.07.2024).

Gjithashtu në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotëronë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësië", nenit 39 "Kërkesat të veçanta për

kontratat për punë publike" pika 6/c dhe c dhe 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" ndër të tjerash përcaktohet se: "Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor Kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose .. c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; 8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Ligji Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.", i ndryshuar,

Meqënëse objekti në fjale ka një shtrirje të madhe në gjatësi, ka shumë penele tërthore, sistemim lumi etj, është e nevojshme që krahas stafit Teknik Drejtues të ketë dhe staf ndihmës (jo drejtues teknik) për të ardhur në ndihmë Inxhinierëve dhe për të realizuar sa më mirë veprën.

Sa me sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për pikeën e mësipërme nuk qëndrojnë dhe nuk pranohen.

IV. Lidhur me pikën e gjashtë të ankesës (pretendimet e ankimuesit)

Të hiqen mjetet si më poshtë vijon pasi në zërrthimin e zërave të punës nuk rezultojnë të nevojshëm për realizimin e punimeve:

Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 10-12 t	3 cope
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes jo me te vogel 20 t	5 cope
Kamioncine me kapacitet mbajtes deri ne 1.5-3.5 t	3 cope
Kamion me vinc	2 cope
Eskavator me zinxhir me krah jo me pak se 18 m	2 cope
Fadrome (mjet teknologjik me goma)	1 cope
Dumper (mjet teknologjik me goma)	2 cope
Grejder (injet teknologjik me goma)	1 cope
Rul ngjeshes me vibrim mbi 15t	2 cope
Autovinc	1 cope
Autobetoniere me kapacitet 2.5 - 3 m3	2 cope
Autobot uji	2 cope
Autobetoniere	4 cope
Autopompe Betoni	2 cope
RTV - Trasportier per mjete te renda	2 cope
Agregat per prerje bimesie	1 cope
Moto generator	2 cope
Betoniere kantieri	1 cope
Vibrues betoni	3 cope
Karroca dore	6 cope
Moto pompe uji	2 cope

KSHA arsyeton dhe argumenton se:

Në lidhje me mjetet e transportit:

Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 10-12 t

Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes jo me te vogel 20 t

Kamioncine me kapacitet mbajtes deri ne 1.5-3.5 t

Kamion me vinc

Dumper (mjet teknologjik me goma)

Në projekt preventiv ndër të tjera është kërkuar:

Gabiona rrjet xingato 1x1x1 = 4000 m³

Gabiona rrjet xingato 1x1x1.5 = 3200 m³

Gabiona rrjet xingato 1x1x2 = 2100 m³

Guri që përdoret për gabiona nuk është material që gjendet në lum por material i importuar, dhe si i tillë transportin e tij duhet ta kryejmë me mjetet e mësipërme, të cilat do të realizojnë transport të brendshëm dhe transport materiali që vjen nga jashtë. Duke nisur nga metodologjia e punimeve prania e mjeteve të tonazheve të ndryshme është e nevojshme sipas proceseve të ndryshme të punës, pasi kemi rrugë të gjëra, rrugë të ngushta, rrugë me pjerrësi të madhe, apo rrugë ku jo të gjitha mjetet e aksesojnë apo mund të kthehen, ndaj kategorizimi i mjeteve është bërë duke parë që projekti s'ka ndërtim rrugësh aksesi është bërë dhe kategorizimi i mjeteve.

Në lidhje me:

Eskavator me zinxhir me krah jo me pak se 18 m

Fadrome (mjet teknologjik me goma)

Këto mjete janë kërkuar për të realizuar hedhjen e materialeve pranë peneleve, meqënëse penelet zgjaten rreth 30-35 m në lumë, për të bërë të mundur hedhjen e materialeve është kërkuar eskavator me krahë të gjatë.

Fadroma është kërkuar për të bërë shtytjen e materialit për ta vendosur pranë peneleve.

Në lidhje me:

Greider (mjet teknologjik me goma) 1 copë

Ky mjet është kërkuar për të niveluar trasenë për kalimin e mjeteve të ndryshme në lumë.

Në lidhje me:

Autovinc 1 cope

Ky mjet është kërkuar për të bërë shkarkimin e materialeve të ndryshme të ndërtimit që nevojiten në vepër, tabela, rrjeta rethimi, motogjenerator, karroca dore, betoniere kantieri, motopompë uji, armaturë betoni.

Në lidhje me:

Autobetoniere me kapacitet 2.5 - 3 m³ 2 cope

Këto mjete janë kërkuar për përgatitien dhe hedhjen e betonit në ato pjesë ku nuk mund të aksesojnë autobetonieret e mëdha, pasi përveç peneleve me gabiona do të kemi dhe sistemim përroi që vjen nga qyteti dhe derdhet në lumë, përrua i cili do të vishet me beton.

Në lidhje me:

Autobot uji 2 cope

Ky mjet është kërkuar për të bërë të mundur larjen e rrugëve dhe pastrimin që mos të ngrihen pluhurat gjatë punimeve, pasi zona që do punohet është pranë qendrës së banuar.

Gjithashtu duhet ujë për procese të ndryshme siç është lagia e betonit, ujitja e pemëve, pastrimi i gurëve, etj.

Në lidhje me:

Autoberoniore 4 cope

Autopompe betoni 2 cope

Referuar preventivit dhe manualit të çmimit kemi punime betoni:

Shtrese betoni C16/20 t=15cm

<i>Nr</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Tipi</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>
<i>manual</i>				
√	<i>Transport auto mbi 10 km</i>	<i>TRANSPORT</i>	<i>t/km</i>	<i>12.48</i>
√	<i>Vinc kulle 4-6 T me manovrator</i>	<i>MAKINERI</i> <i>DHE PAJISJE</i>	<i>cp</i>	<i>0.73</i>
√	<i>Beton C-16/20 (Me zall)</i>	<i>MATERIAL</i>	<i>m3</i>	<i>1.04</i>
√	<i>SP+P (paga bruto + kontributet)</i>	<i>PUNTORI</i>	<i>op</i>	<i>8.6</i>

Një nga zërat e përbërës të betonit është dhe Transporti i Betonit, dhe për të realizuar këtë transport nevojiten autobetonieret, ndërsa për hedhjen e betonit është e nevojshme Autopompa e betonit. Këto mjete janë dhe referuar analizës së çmimit të manualit teknik.

Në lidhje me:

RTV - Trasporter per mjete te renda 2 cope

Për të sjellë në objekt eskavatorë me zinxhirë dhe paisjet e ndryshme nevojiten RTV.

Në lidhje me:

Agregat per prerje bimesie 1 cope

Është kërkuar për të bërë pastrimin e përroit dhe rrugëve nga bimët e ndryshme, pemë që pengojnë punën etj.

Në lidhje me:

Moto gjenerator 2 cope

Këto paisje janë kërkuar për të bërë të mundur pasjen e energjisë elektrike për kryerjen e proceseve të ndryshme siç janë, vënia në punë e vibratorëve të betonit, motopompës ujit, kthyeses së hekurit, ndriçimin e objektit etj, pasi është objekt në lumë dhe s'ka pikë lidhje energjie.

Në lidhje me:

Betoniere kantieri 1 cope

Kjo paisje është kërkuar për të realizuar beton në ato pjesë të kanalit ku nuk futet autobetoniera e madhe, dhe autobetoniere 2.5 m3.

Në lidhje me:

Vibrues betoni 3 cope

Këto paisje kërkohen për vibrimin e betonit. Referuar dhe zbërthimit të analizave teknike të zërave në preventiv, të pranuar dhe nga vetë operatori ankimes rezulton se ky zë është i nevojshëm.

Në lidhje me:

Karoca dore 6

Këto paisje janë të nevojshme për transportin e materialeve të imta dhe të vogla në objekt, siç janë transport dërrasash, binarë, tel të xinguar për lidhjen e rrjetes së gabionave etj.

Në lidhje me:

Moto pompe uji 2 cope

Këto paisje janë kërkuar për marijen e ujit nga autoboti dhe nga depozitat dhe shtytjen e tij në distanca të largëta ku nuk shkon mjeti për të realizuar lagjen e betonit.

Për këto arsye pretendimet e ankuesit nuk qëndrojnë. [...].

III.2.4. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dërguar me shkresën nr. 3062/3 prot., datë 22.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 1943/2 prot datë 22.07.2024, drejtuar ankimesit si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) konstatohet së më datë 15.07.2024, enti prokurues ka modifikuar kriteret kualifikues të përcaktuara në pikat 2.3.4 dhe 2.3.8 “Aftësitë teknike dhe profesionale” të shtojcës 7 “**FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**”, si më poshtë vijon:

[...]

ISHTE

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar** për kryerjen e punimeve, të cilët duhet të jenë të pajisur me Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar, sipas profileve të më poshtëme:

- Teknik Ndërtimi	1 (nje)
- Teknik Gjeolog	1 (nje)
- Teknik Gjeodet/Topograf	1 (nje)
- Teknik Hidroteknik	1 (nje)
- Murator	9 (nente)
- Karpentier	9 (nente)
- Hekurkthyes	3 (tre)
- Hidroizolues	1 (nje)
- Punonjes Guri/Gurepunues	10 (dhjete)

❖ **Shënim:** Gjate fazes së ofertimit, në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8), në pika B. - Deklarata - “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik për punonjesit e mesiperm **duhet të deklarojnë:** emer/mbiemer, profilin e punes, subjektin leshues të

certifikates/diplomes, Nipt (ne rastin kur subjekti leshues i certifikates/diplomes eshte privat).

Diplomat/çertifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.
Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtem:

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh. ”, i ndryshuar.
- Të paraqiten listepagesat përkatëse të shoqërisë minimalisht të 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipërm të figurojnë .
- Per teknikun e ndertimit, teknikun hidroteknik, teknikun gjeodet, teknikun teknikun gjeolog duhet te paraqitet dhe deftese e shkolles se mesme.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

BËHET

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar** për kryerjen e punimeve, te cilet duhet te jene te pajisur me Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh. ”, i ndryshuar, sipas profileve te më poshtëme:

- Teknik Ndërtimi	1 (nje)
- Teknik Gjeodet/Topograf	1 (nje)
- Teknik Hidroteknik	1 (nje)
- Murator	9 (nente)
- Karpentier	9 (nente)
- Hekurkthyes	3 (tre)
- Punonjes Guri/Gurepunues	10 (dhjete)

- ❖ **Shënim:** Gjate fazes se ofertimit, në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit (shtojca 8), ne pika B. - Deklarata - “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik per punojesit e mesiperm **duhet të deklarojnë:** emer/mbiemer, profilin e punes, subjektin leshues te

certifikates/diplomes, Nipt (ne rastin kur subjekti leshues i certifikates/diplomes eshte privat).

Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin nga pjesëmarrja në prokurimet publike.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtem:

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh. ”, i ndryshuar.
- Të paraqiten listepagesat përkatëse të shoqërisë minimalisht të 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipërm të figurojnë .
- Per teknikun e ndertimit, teknikun hidroteknik, teknikun gjeodet, teknikun teknikun gjeolog duhet te paraqitet dhe deftese e shkolles se mesme.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

ISHTE

2.3.8. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Makineri dhe pajisje	Nr.	Njesia	Gjendja
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 10-12 t	3	cope	Ne pronesi ose me qera
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes jo me te vogel 20 t	5	cope	Ne pronesi ose me qera
Kamioncine me kapacitet mbajtes deri ne 1.5-3.5 t	3	cope	Ne pronesi ose me qera
Kamion me vinc	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Eskavator me Goma (mjet teknologjik me goma)	3	cope	Ne pronesi ose me qera
Eskavator me zinxhir me krah jo me pak se 18 m	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Fadrome (mjet teknologjik me goma)	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Dumper (mjet teknologjik me goma)	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Grejder (mjet teknologjik me goma)	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Rul ngjeshes me vibrim mbi 15t	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Autovinc	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Autobetoniere me kapacitet 2.5 - 3 m3	2	cope	Ne pronesi ose me qera

<i>Autobot uji</i>	2	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Autobetoniere</i>	4	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Autopompe Betoni</i>	2	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>RTV - Transportier per mjete te renda</i>	2	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Agregat per prerje bimesie</i>	1	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Moto gjenerator</i>	2	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Betoniere kantieri</i>	3	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Vibrues betoni</i>	5	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Karoca dore</i>	6	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Moto pompe uji</i>	2	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Kethyese hekuri / bango hekuri</i>	1	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>G.P.S</i>	1	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Total Station</i>	1	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Kokore</i>	72	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Jelek</i>	72	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Tabela sinjalizuese kantieri</i>	4	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Komplet i ndihmes se shpejte</i>	2	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Ëellpoint</i>	1	<i>cope</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Armaturë/betoforma/lendë drusore</i>	500	<i>M2</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Impiant prodhim betoni me QKL</i>	1	<i>cope</i>	<i>Nëpronësi, me qera, osekcontratëfurnizimi</i>
<i>Nyje Inerte</i>	1	<i>cope</i>	<i>Nëpronësi, me qera, osekcontratëfurnizimi</i>

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.*

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:

e) Për mjetet në pronësi, që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

- 1. Dokument qe verteton pronesine e mjetit.*
- 2. Leje qarkullimi (e vlefshme)*
- 3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)*
- 4. Police sigurimi (e vlefshme)*
- 5. Leje transporti, leshuar nga pushteti vendor (e vlefshme)*

f) Për mjetet e marra me qera, që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

- 1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj (e vlefshme).*
- 2. Leje qarkullimi (e vlefshme)*
- 3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)*
- 4. Police sigurimi (e vlefshme)*
- 5. Leje transporti per vete dhe te trete (leshuar nga pushteti vendor e vlefshme)*

g) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeteve dhe targa e tij.

h) Operatori ekonomik duhet të deklarojë vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me anë të një deklarate të firmosur dhe vulosur nga Administratori, me qëllim të verifikimit nga Autoriteti Kontraktor

Ne rast se operatori ekonomik nuk disponon mjet RTV – Transportues për mjetet e renda mund të paraqesë kontratë bashkëpunimi të vlefshme për gjithë periudhën që zgjasin punimet.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e verifikimit të saktësisë së informacionit. Mos dorëzimi i informacionit të saktë apo të rremë do të konsiderohet kusht për skualifikim dhe/ose fillim i hetimit administrativ për përjashtim të Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

BËHET

2.3.8. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Makineri dhe pajisje	Nr.	Njesia	Gjendja
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 10-12 t	3	cope	Ne pronesi ose me qera
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes jo me te vogel 20 t	3	cope	Ne pronesi ose me qera
Kamioncine me kapacitet mbajtes deri ne 1.5-3.5 t	3	cope	Ne pronesi ose me qera
Kamion me vinc	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Eskavator me Goma (mjet teknologjik me goma)	3	cope	Ne pronesi ose me qera
Eskavator me zinxhir me krah jo me pak se 18 m	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Fadrome (mjet teknologjik me goma)	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Dumper (mjet teknologjik me goma)	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Grejder (mjet teknologjik me goma)	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Autovinc	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Autobetoniere me kapacitet 2.5 - 3 m3	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Autobot uji	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Autobetoniere	4	cope	Ne pronesi ose me qera
Autopompe Betoni	2	cope	Ne pronesi ose me qera
RTV - Transportier per mjete te renda	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Agregat per prerje bimesie	1	cope	Ne pronesi ose me qera
Moto gjenerator	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Betoniere kantieri	3	cope	Ne pronesi ose me qera
Vibrues betoni	5	cope	Ne pronesi ose me qera
Karoca dore	6	cope	Ne pronesi ose me qera
Moto pompe uji	2	cope	Ne pronesi ose me qera
Kethyese hekuri / bango hekuri	1	cope	Ne pronesi ose me qera
G.P.S	1	cope	Ne pronesi ose me qera

<i>Total Station</i>	1	cope	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Kokore</i>	72	cope	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Jelek</i>	72	cope	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Tabela sinjalizuese kantieri</i>	4	cope	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Komplet i ndihmes se shpejte</i>	2	cope	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Ëëllpoint</i>	1	cope	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Armaturë/betoforma/lendë drusore</i>	500	M2	<i>Ne pronesi ose me qera</i>
<i>Impiant prodhim betoni me QKL</i>	1	cope	<i>Nëpronësi, me qera, osekcontratëfurnizimi</i>
<i>Nyje Inerte</i>	1	cope	<i>Nëpronësi, me qera, osekcontratëfurnizimi</i>

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.*

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:

i) Për mjetet në pronësi, që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

- 1. Dokument qe verteton pronesine e mjetit.*
- 2. Leje qarkullimi (e vlefshme)*
- 3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)*
- 4. Police sigurimi (e vlefshme)*
- 5. Leje transporti, leshuar nga pushteti vendor (e vlefshme)*

j) Për mjetet e marra me qera, që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

- 1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj (e vlefshme).*
- 2. Leje qarkullimi (e vlefshme)*
- 3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)*
- 4. Police sigurimi (e vlefshme)*
- 5. Leje transporti per vete dhe te trete (leshuar nga pushteti vendor e vlefshme)*

k) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

l) Operatori ekonomik duhet te deklaroje vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me anë të një deklarate të firmosur dhe vulosur nga Administratori, me qëllim te verifikimit nga Autoriteti Kontraktor

Ne rast se operatori ekonomik nuk disponon mjet RTV – Transportues per mjetet e renda mund te paraqese kontrate bashkepunimi te vlefshme per gjithe periudhen qe zgjasin punimet.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten e verifikimit te saktësisese informacionit. Mos dorëzimi i informacionit të saktë apo të rremë do te konsiderohet kusht për skualifikim dhe/ose fillim i hetimit administrativ për perjashtim të Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit. [...].

III.2.5. Në Nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërsa në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.2.6. Në Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.2.7. Në nenin 39, pika 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”.

III.2.8. Në nenet 2, 9, 10 dhe 17 të ligjit nr. 15/2017, datë 16.02.2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, i ndryshuar, përcaktohet se:

Neni 2

Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka për qëllim:

a) të krijojë dhe të zhvillojë një sistem të njëzuar të AFP-së që t'u përgjigjet ndryshimeve social-ekonomike dhe teknologjike, në përputhje të plotë me nevojat e tregut vendas e global të punës;

b) të krijojë mekanizma të qëndrueshëm të sigurimit dhe garantimit të cilësisë në institucionet e arsimit profesional, në përputhje me standardet e Bashkimit Europian;

c) të modernizojë sistemin e AFP-së, duke e bërë atë një mekanizëm më efektiv dhe më të efektshëm për rritjen e ritmeve të zhvillimit të ekonomisë e të shoqërisë shqiptare, duke siguruar pajtueshmërinë e tij me sistemin arsimor dhe tregun e punës;

ç) të garantojë mundësi të barabarta për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në AFP.

Neni 9

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

1. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, veç detyrave të tjera të përcaktuara nga ligje të tjera, është përgjegjëse për aspektet e menaxhimit që lidhen me ofruesit publikë të AFP-së.

2. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive është e ngarkuar me mbajtjen e një regjistri me certifikatat përfundimtare dhe me suplementet e certifikatave të lëshuara nga ofruesit e AFP-së dhe kryerjen e studimeve për gjurmimin e të diplomuarve të AFP-së.

3. Organizimi, funksionimi dhe kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Kompetencat e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

1. Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve ka këto kompetenca:

- a) harton dhe mirëmban Listën Kombëtare të Profesioneve;
 - b) harton dhe mirëmban Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale për nivelet 2-5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;
 - c) harton programet kombëtare dhe materiale mbështetëse për kualifikimet profesionale të niveleve 2-5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;
 - ç) harton programet e kurseve të unifikuara të formimit profesional publik;
 - d) monitoron kualifikimin e vazhduar të personelit mësimdhënës të kulturës profesionale të ofruesve të AFP-së;
 - dh) harton standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të AFP-së;
 - e) akrediton ofruesit e AFP-së për kualifikimet profesionale të niveleve 2-5 të KSHK-së;
 - ë) përcakton kriteret e vlerësimit dhe certifikimit për nxënësit në sistemin e AFP-së.
2. Organizimi dhe veprimtaria e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 17

Katalogu Kombëtar i Kualifikimeve Profesionale

1. Katalogu Kombëtar i Kualifikimeve Profesionale përmban emërtimet, standardet dhe dokumente të tjera kombëtare përkatëse për secilin kualifikim, në lidhje me njohuritë, aftësitë dhe kompetencat.

2. Katalogu Kombëtar i Kualifikimeve Profesionale miratohet nga ministri përgjegjës për AFP-në.

III.2.9. Me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 99, datë 25.5.2021 “PËR MIRATIMIN E KATALOGUT KOMBËTAR TË KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE”, i ndryshuar, është miratuar katalogu kombëtar i kualifikimeve profesionale.

III.2.10. Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve në ushtrimin e detyrave të ngarkuara me ligj ka publikuar në faqen e saj zyrtare të internetit ka publikuar skeletkurikulën për profilin mësimor “PUNIME MURATIMI DHE SUVATIMI” ku në pikën II “Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për “Punime muratimi dhe suvatimi”, në pikën V “Modulet e Kursit për “Punime muratimi dhe suvatimi” dhe në pikën 3 “Moduli “Punime muratimi” është përcaktuar si më poshtë:

“II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për “Punime muratimi dhe suvatimi”

Në përfundim të Kursit për “Punime muratimi dhe suvatimi”, kursantët do të jenë të aftë të:

- Interpretojnë projektin dhe specifikimet teknike të punës që do kryejnë

- Llogarisin volumet e punës dhe materialet për punimet e muratimit dhe të suvatimit
- Skicojnë detaje të ndryshme të lidhjeve të mureve me tulla
- Bëjnë organizimin e vogël të punës

2

- Përzgjedhin materialet e nevojshme dhe veglat e punës para fillimit të procesit të punës
- Bëjnë pikekimin e akseve dhe trashësisë së mureve të objektit
- Bëjnë nivelimin e themelit para fillimit të procesit të ndërtimit të muraturës
- Përpunojnë tullat, blloqet, gurët sipas madhësisë që nevojiten
- Ndërtojnë murin me lartësi sipas projektit dhe kontrollojnë lidhjen e fugave
- Ndërtojnë kolloneta e breza përforcues b/a në pozicionin e duhur të murit dhe vendosin arkitrarët e gatshëm
- Kontrollojnë me instrumente rrafshësinë e tavaneve e mureve
- Përgatisin llaçet për shtresat përkatëse të suvatimeve
- Realizojnë suvatimet e tavaneve dhe mureve të jashtëm e të brendshëm
- Realizojnë stukimin dhe lyerjen e ndërtesës
- Kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për punimet muratimi dhe suvatimi
- Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit
- Mirëmbajnë veglat e instrumentet dhe sistemojnë materialet mbas punës.

V. Modulet e Kursit për “Punime muratimi dhe suvatimi”

Nr	Titulli i Modulit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
3	Punime muratimi.	MK-02-069-18	130 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti ndërton mur guri e butobetoni. 2. Kursanti ndërton mure me tulla e blloqe. 3. Kursanti ndërton mure me shtresë termoizoluese 4. Kursanti ndërton mure me tulla xhami. 5. Kursanti ndërton mure me gurë natyror në të thatë. 6. Kursanti ndërton mure me rrasa guri të gatshme në të thatë. 7. Kursanti ndërton mure me gabiona.

Moduli “Punime muratimi”

<p>Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit</p>	<p>RM 1 Kursanti ndërton mur guri e butobetoni.</p> <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë dokumentacionin teknik për muratim - të analizojë objektin ku do të bëhet muratimi - të përzgjedhë veglat, instrumentat dhe materialet e punës - të përgatisë llaçin dhe vendosë guret e rrjeshtit të parë bashkë me spangon; - të mbushë boshlleqet me gurë të vegjël; - të shtrojë llaçin e ndërtojë murin e gurit duke e kontrolluar me instrumente; - të nivelojë rrjeshtin e fundit të murit me llaç; - të formojë kallëpin sipas përmasave në skicë; - të montojë dhe përforcoje kallëpin; - të përgatisë betonin për markën e dhënë; - të hedhë betonin në kallëp duke hedhur e ngjeshur gurët në të;
	<p>të heqë kallëpin në kohën e duhur;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të mirëmbajë murin e ndërtuar; - të kryejë matjet dhe kontrollet e duhura - të mirëmbajnë veglat dhe sistemojnë materialet mbas mbarimit të punës; - të kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për ndërtimin e murit me gur e butobuton; - të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik; <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli.

	<p>RM5 Kursanti ndërton mure me gurë natyror në të thatë (pa llaç). .</p> <p>Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë dokumentacionin teknik për muratim - të analizojë objektin ku do të bëhet muratimi - të përzgjedhë veglat, instrumentat dhe materialet e punës - të piketojë me spango tokën sipas trashësisë së murit; - të punojë dhe të thellojë 15 cm tokën para fillimit të ndërtimit të murit; - të vendosë gurët në rrjeshtin e parë duke i ngjeshur fort me tokën; - të mbushë me tokë dhe mbeturina rrethore boshllëqet midis gurëve - të ndërtojë murin me gure në të thatë deri në lartësi e lejuar sipas kushteve teknike; - të mirëmbajë veglat dhe të sistemojë materialet mbas mbarimit të punës.
	<ul style="list-style-type: none"> -të kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për ndërtimin e murit me tulla me gurë natyror në të thatë - të zbatojnë rregullat e sigurimit teknik; <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetje përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli..

III.2.11. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht dëshmi për përvojën e mëparshme. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi, ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP-së.

III.2.12.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit të parashtruara në ankesën e datës 16.07.2024 për modifikimin e kriterëve kualifikuese të përcaktuara në pikat 2.3.4 dhe 2.3.8 “*Aftësitë teknike dhe profesionale*”, të shtojcës 7 “*FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” dhe konkretisht për sa i përket pretendimeve për heqjen e kërkesës që operatori ekonomik ofertues të disponojë në stafin e tij punonjës të specializuar për kryerjen e punimeve, të cilët duhet të jenë të pajisur me certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “*Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.*”, i ndryshuar, sipas profilit “*Teknik gjeolog*” dhe profilit “*Hidroizolues*”, si dhe heqjes së kërkesës që operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet “*Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes jo me te vogel 20 t*” dhe “*Rul ngjeshes me vibrim mbi 15t*”, Komisioni i Prokurimit Publik referuar informacionit të autoritetit kontraktor të administruar në dosjen objekt-shqyrtimi, konstaton se autoriteti kontraktor më datë 15.07.2024 ka modifikuar këto kriterë kualifikuese, duke hequr kërkesat e sipërpërmendura, si edhe ka publikuar po më datë 15.07.2024 shtojcës mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit publikuar nga autoriteti kontraktor në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.

Pra, sa më sipër, autoriteti kontraktor në lidhje me pretendimin e mësipërm ndonëse nuk e ka marrë në shqyrtim këtë pretendim e ka pranuar atë për shkak të modifikimit të këtyre kriterëve kualifikuese me iniciativën e tij, si dhe ka publikuar shtojcën me ndryshimin përkatës në sistemin e prokurimeve elektronike. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, duke qenë se ankesa e operatorit ekonomik “*B93 IP*” SHPK në lidhje me pretendimet e mësipërm, është pranuar nga autoriteti kontraktor, dhe janë pasqyruar edhe ndryshimet përkatëse, në SPE në shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit, rrjedhimisht këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim në themel, pasi nuk ekzistojnë më si objekt-ankimi.

Përsa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.

III.2.12.2. Lidhur me pretendimet e ankimuesit si në vijim: “*Referuar punimeve të preventivit të punimeve dhe detajimit të tij del e panevojshme kërkesa për specialistë punëtorë si më poshtë vijon për të cilët kërkohet të hiqen nga kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.3.4:*

Murator 9 : Në asnjë zë të preventivit nuk parashikohen punime muri prandaj duhet të hiqet si kriter punimesh.

Punonjës Guri/Gurëpunues: Në asnjë zë të preventivit nuk parashikohen punime guri prandaj duhet të hiqet si kriter punimesh.”, Komisioni konstaton se në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.4 “*Aftësitë teknike dhe profesionale*”, të shtojcës 7 “*FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të modifikuara, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë në stafin e tij punonjës të specializuar për kryerjen e punimeve, të cilët duhet të jenë të pajisur me certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “*Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.*”, i ndryshuar, sipas profilit “*Murator*” dhe profilit “*Punonjës Guri/Gurëpunues*”.

Ndërkohë referuar preventivit të punimeve të publikuar në sistemin e prokurimeve elektroklike (SPE), Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se zërat e punimeve objekt prokurimi janë edhe

zërat si në vijim: “3.331 Gabiona rrjet xingato 1x1x1; 3.332 Gabiona rrjet xingato 1x1x1.5; 3.333 Gabiona rrjet xingato 1x1x2 dhe 1.262/4 Shtrese betoni C-16/20 t=15cm”, ku nga analiza teknike e këtyre zërave të bëra nga ana e ankimuesit dhe të pasqyruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2024/4331 datë 16.07.2024, dhe me nr. 1943/2024 prot, datë 16.07.2024, si dhe në analizën teknike të këtyre zërave të bëra nga ana e komisionit të shqyrtimit të ankesës dhe pasqyruara në shkresën nr. 3062/3 prot., datë 22.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 1943/2 prot datë 22.07.2024, ku keto analiza janë bërë sipas përcaktimeve të VKM-së Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, vërehet se zërat e punimeve “3.331 Gabiona rrjet xingato 1x1x1; 3.332 Gabiona rrjet xingato 1x1x1.5 dhe 3.333 Gabiona rrjet xingato 1x1x2” kërkojnë material “Gur kave” dhe punonjës për tu realizuar, ndërkohë që edhe zëri i punimeve: “1.262/4 Shtrese betoni C-16/20 t=15cm” kërkon materialet “Çimento”, “Zall i larë lavatrice”, “Rere e lare”, “Kallëpe” dhe punonjës për tu realizuar.

Për më tepër, lidhur me pretendimet e mësipërme të ankimuesit, komisioni i shqyrtimit të ankesës në shkresën nr. 3062/3 prot., datë 22.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 1943/2 prot datë 22.07.2024, shprehet se: “Referuar Analizave të Manualit Teknik në fuqi Zërat e punimeve Gabion kanë nënzerat e mësipërme, ku njëri nga elementët kryesorë është GURI KAVE (që nënkupton gur të xjerreë nga karrierat, me shpërthime apo me metoda të ndryshme, gur ky që vjen në forma dhe madhësi të ndryshme, që duhet të përshtaten për ndërtimin e Pritave apo Penelave në lumë, sipas vizatimeve teknike në projekt).

Fig nr 1 (shembull i një Mbrotjtje me Gabion, Foto e marrë nga Interneti)

Referuar kurrikulave të formimit profesional apo të formimit të specialiteteve të ndryshme në fushën e ndërtimit Muratori i realizon punimet si më poshtë:

Ndërtim mur guri e butobetoni, me tulla e bloqe, mure me shtresë termoizoluese, me tulla xhami, me gur natyror në të thatë, si dhe mure me gabiona.

Përgatitjen dhe punimin e gurit në forma dhe madhësi të lejueshme për tu vendosur brenda në koshat me rrjete të gabionave e realizon - Punonjës Guri/Gurëpunues.”, duke argumentuar teknikisht nevojën që operatorët ekonomik ankimues të kenë në stafin e tyre punonjës të profilit “Murator” dhe të profilit “Punonjës Guri/Gurëpunues” me qëllim realizimin me sukses të këtyre zërave të preventivit objekt prokurimi.

Gjithashtu, Komisioni konstaton se punonjësit me profesionin murator nuk është i nevojshëm për kryerjen e zërave të mësipërm të preventivit objekt-prokurimi të publikuar në dokumentat e tenderit të kësaj procedure prokurimi, sepse referuar skeletkurrikulës për profilin mësimor “PUNIME MURATIMI DHE SUVATIMI” të publikuar nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve konstatohet se në përfundim të këtij kursi formimi profesional, punonjësi i kualifikuar kryen këto zëra të preventivit, pasi është i kualifikuar për kryerjen e punimeve të betonit dhe mureve të gabionit me rrjetë xingato dhe gurë kave.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se pretendimet e mësipërme të ankimuesit nuk qëndrojnë, pasi referuar analizës teknike të zërave të preventivit objekt prokurimi të bëra nga vetë ankimuesi, konstatohet se punonjësit e kualifikuar të sipërkërkuar janë të nevojshëm për realizimin me sukses të këtyre punimeve që përfshijnë këto zëra në preventiv.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.2.12.3. Lidhur me pretendimet e ankimesit si në vijim: “*Duket e panevojshme prania e secilit teknik krahas çdo inxhinieri ndërtimit. Autoriteti kontraktor të vërë njëvlefshmërinë me titullin inxhinier për profilet teknik të mësipërm mqs e mbulon dhe tejkalon arsimimet e mësipërme të individëve.*”, Komisioni konstaton se në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “*Aftësitë teknike dhe profesionale*”, të shtojcës 7 “*FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë në stafin e tij drejtues 1 (një) drejtues teknik me profesionin inxhinier hidroteknik, 1 (një) drejtues teknik me profesionin inxhinier ndërtimi, 1 (një) drejtues teknik me profesionin inxhinier ndërtimi (Profili Gjeoteknik) dhe 1 (një) inxhinier ndërtimi me profesionin inxhinier topograf, ndërkohë që në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.4 “*Aftësitë teknike dhe profesionale*”, të shtojcës 7 “*FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të modifikuar, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë në stafin e tij punonjës të specializuar për kryerjen e punimeve, të cilët duhet të jenë të pajisur me certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “*Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.*”, i ndryshuar, dhe konkretisht 1 (një) teknik ndërtimi, 1 (një) teknik gjeodet/topograf dhe 1 (një) teknik hidroteknik.

Ndërkohë referuar shkresës nr. 3062/3 prot., datë 22.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 1943/2 prot datë 22.07.2024, të komisionit të shqyrtimit të ankesave pranë autoritetit kontraktor, ky i fundit lidhur me pretendimet e ankimesit është shprehur si në vijim: “*Pra, në Shtojcën e nxjerrë nga Autoriteti Kontraktor është hequr **Inxhinieri Gjeolog, Tekniku gjeolog dhe hidroizoluesi.** Operatori ekonomik ankimes përpara hartimit të ankesës duhet ti referohet Dokumentave Standarte Të Tenderit dhe ndryshimeve që ajo ka pësuar (në rastin e procedurës tonë kemi shtojcë në datën 15.07.2024).*”

Gjithashtu në bazë të pikës 4, të nenit te 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotëronë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësië", nenit 39 "Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike" pika 6/c dhe c dhe 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" ndër të tjerash përcaktohet se: "Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor Kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshem për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose .. c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; 8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.", i ndryshuar,

Meqënëse objekti në fjale ka një shtrirje të madhe në gjatësi, ka shumë penele tërthore, sistemim lumi etj, është e nevojshme që krahas stafit Teknik Drejtues të ketë dhe staf ndihmës

(jo drejtues teknik) për ti ardhur në ndihmë Inxhinierëve dhe për të realizuar sa më mirë veprën.”, duke mos argumentuar teknikisht nevojën e disponimit në stafin mbështetës të punonjësve me profesionin teknik ndërtimi, teknik gjeodet/topograf dhe teknik hidroteknik. Nisur nga sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor që operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë në stafin e tij mbështetës 1 (një) teknik ndërtimi, 1 (një) teknik gjeodet/topograf dhe 1 (një) teknik hidroteknik është një kërkesa e dubluar, pasi në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 “Aftësitë teknike dhe profesionale”, të shtojcës 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë në stafin e tij drejtues 1 (një) drejtues teknik me profesionin inxhinier hidroteknik, 1 (një) drejtues teknik me profesionin inxhinier ndërtimi, 1 (një) drejtues teknik me profesionin inxhinier ndërtimi (Profili Gjeoteknik) dhe 1 (një) inxhinier ndërtimi me profesionin inxhinier topograf, të cilët janë më të kualifikuar se teknikët e përcaktuar në kriterin kualifikues të pikës 2.3.4 “Aftësitë teknike dhe profesionale”, të shtojcës 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të modifikuara.

Për më tepër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar teknikisht nevojën që operatori ekonomik ofertues të disponojë në stafin mbështetës 1 (një) teknik ndërtimi, 1 (një) teknik gjeodet/topograf dhe 1 (një) teknik hidroteknik për realizimin më sukses të zërave të preventivit objekt prokurimi.

Përsa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit kualifikues të pikës 2.3.4 “Aftësitë teknike dhe profesionale”, të shtojcës 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të modifikuara, duke hequr kërkesën që operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë në stafin e tij mbështetës 1 (një) teknik ndërtimi, 1 (një) teknik gjeodet/topograf dhe 1 (një) teknik hidroteknik, si një kërkesë e dubluar dhe e panevojshme.

Për sa më sipër pretendimi i ankimesit qëndron.

III.2.12.4. Lidhur me pretendimet e ankimesit për modifikimin e kriterit kualifikues përsa i përket fuqisë punëtore që duhet të disponojë operatori ekonomik ofertues, Komisioni konstaton se në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.6 “Aftësitë teknike dhe profesionale”, të shtojcës 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të modifikuara, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë në stafin e tij jo me pak se 72 (shtatëdhjetë e dy) punonjës.

Ndërkohë referuar preventivit të punimeve të publikuar në sistemin e prokurimeve elektroteknike (SPE), Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se zërat e punimeve objekt prokurimi të bëra nga ana e ankimesit dhe të pasqyruara në formularin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2024/4331 datë 16.07.2024, dhe me nr. 1943/2024 prot, datë 16.07.2024, duhet një fuqi punëtore prej 68 punonjësish, por pa përfshirë drejtuesit teknik të kërkuar në kriterin kualifikues të pikës 2.3.3 “Aftësitë teknike dhe profesionale”, të shtojcës 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të modifikuara, ndërkohë referuar analizën teknike të zërave të preventivit duhet një fuqi punëtore prej 72 (shtatëdhjetë e

dy) punonjësish ku përfshihen 68 (gjashtëdhjet e tetë) punonjës sipas analizës teknike të zërave të punimeve, si dhe 4 (katër) drejtues teknik të përcaktuar në kriterin kualifikues të pikës 2.3.3 “Aftësitë teknike dhe profesionale”, të shtojcës 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të modifikuara, 1 (një) inxhinier mjedisi të përcaktuar në kriterin kualifikues të pikës 2.3.3/1 “Aftësitë teknike dhe profesionale”, të shtojcës 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të modifikuara dhe 3 (tre) teknik të mesëm të përcaktuar në kriterin kualifikues të pikës 2.3.4 “Aftësitë teknike dhe profesionale”, të shtojcës 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të modifikuara. Pra në përcaktimin e numrit të punonjësve autoriteti kontraktor është mbështetur në analizën teknike të zërave të preventivit sipas përcaktimeve të VKM-së Nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për realizimin e këtyre zërave të punimeve dhe në përcaktimet e kriterëve kualifikuesë të pikës 2.3.3, 2.3.3/1 dhe 2.3.4 “Aftësitë teknike dhe profesionale”, të shtojcës 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të modifikuara.

Nga shqyrtimi i pretendimeve të ankimuesit, Komisioni konstaton se referuar pikës III.1.9. dhe III.2.12.3 të këtij vendimi autoriteti kontraktor do të modifikojë përkatësisht kriteret kualifikuesë të pikave 2.3. dhe 2.3.4 “Aftësitë teknike dhe profesionale”, të shtojcës 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të modifikuara, ndërkohë që referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dërguar me shkresën nr. 3062/3 prot., datë 22.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 1943/2 prot datë 22.07.2024, rezulton se autoriteti kontraktor ka modifikuar kriteret kualifikuesë të përcaktuara në pikat 2.3.3/1 dhe 2.3.4 “Aftësitë teknike dhe profesionale”, të shtojcës 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit, duke publikuar më datë 15.07.2024 shtojcën përkatëse.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se pretendimi i mësipërm i ankimuesit qëndron pjesërisht, ndaj autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit kualifikues në përputhje me analizat e zërave të punimeve objekt prokurimi, përcaktimet e pikave III.1.9. dhe III.2.12.3 të këtij vendimi dhe duke patur parasysh modifikimet e kriterëve kualifikuesë të përcaktuara në pikat 2.3.3/1 dhe 2.3.4 të “Aftësitë teknike dhe profesionale”, të shtojcës 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të bëra më datë 15.07.2024.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

III.2.12.5. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e kriterit kualifikues përsa i përket mjeteve dhe paisjeve që duhet të disponojë operatori ekonomik ofertues në vijim: “Në mënyrë të përmbledhur, sipas zërthimit të preventivit të punimeve dhe analizave përkatëse rezultojnë kërkesat si më poshtë në lidhje me fuqinë punëtore dhe makineritë:

Fuqi Punëtore 68 punonjës

Mjet Eskavator 0.5m3 3 copë

Betoniere 2 copë

Vibrator thellësie 2 copë.

Të hiqen mjetet si më poshtë vijon pasi në zërthimin e zërave të punës nuk rezultojnë të nevojshëm për realizimin e punimeve:

Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 10-12 t, Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës jo më të vogël 20 t, Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri në 1.5-3.5 t, Kamion me vinc, Eskavator me zinxhir me krah jo më pak se 18 m, Fadromë (mjet teknologjik me goma), Dumper (mjet teknologjik me goma), Grejder (mjet teknologjik me goma), Rul ngjeshës me vibrim mbi 15t, Autovinc, Autobetoniere me kapacitet 2.5 - 3 m³, Autobot uji, Autobetoniere, Autopompë Betoni, RTV - Transportier për mjete të rënda, Agregat për prerje bimësie, Moto gjenerator, Betoniere kantieri, Vibruer betoni, Karroca dore dhe Moto pompë uji”, Komisioni konstaton se në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.8 “Aftësitë teknike dhe profesionale”, të shtojcës 7 “FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të modifikuara, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë mjete dhe pajisje për realizimin e zërave të preventivit objekt prokurimi.

Për pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimmue, komisioni i shqyrtimit të ankesës në shkresën nr. 3062/3 prot., datë 22.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 1943/2 prot datë 22.07.2024, shprehet se: “KSHA arsyeton dhe argumenton se:

Në lidhje me mjetet e transportit:

Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 10-12 t

Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës jo më të vogël 20 t

Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri në 1.5-3.5 t

Kamion me vinc

Dumper (mjet teknologjik me goma)

Në projekt preventiv ndër të tjera është kërkuar:

Gabiona rrjet xingato 1x1x1 = 4000 m³

Gabiona rrjet xingato 1x1x1.5 = 3200 m³

Gabiona rrjet xingato 1x1x2 = 2100 m³

Guri që përdoret për gabiona nuk është material që gjendet në lum por material i importuar, dhe si i tillë transportin e tij duhet ta kryejmë me mjetet e mësipërme, të cilat do të realizojnë transport të brendshëm dhe transport materialit që vjen nga jashtë. Duke nisur nga metodologjia e punimeve prania e mjeteve të tonazheve të ndryshme është e nevojshme sipas proceseve të ndryshme të punës, pasi kemi rrugë të gjëra, rrugë të ngushta, rrugë me pjerrësi të madhe, apo rrugë ku jo të gjitha mjetet e aksesojnë apo mund të kthehen, ndaj kategorizimi i mjeteve është bërë duke parë që projekti s’ka ndërtim rrugësh aksesi është bërë dhe kategorizimi i mjeteve.

Në lidhje me:

Eskavator me zinxhir me krah jo më pak se 18 m

Fadrome (mjet teknologjik me goma)

Këto mjete janë kërkuar për të realizuar hedhjen e materialeve pranë peneleve, meqënëse penelet zgjaten rreth 30-35 m në lumë, për të bërë të mundur hedhjen e materialeve është kërkuar eskavator me krahë të gjatë.

Fadroma është kërkuar për të bërë shtytjen e materialit për ta vendosur pranë peneleve.

Në lidhje me:

Grejder (mjet teknologjik me goma) 1 copë

Ky mjet është kërkuar për të niveluar trasenë për kalimin e mjeteve të ndryshme në lumë.

Në lidhje me:

Autovinc 1 cope

Ky mjet është kërkuar për të bërë shkarkimin e materialeve të ndryshme të ndërtimit që nevojiten në vepër, tabela, rrjeta rethimi, motogjenerator, karroca dore, betoniere kantieri, motopompë uji, armaturë betoni.

Në lidhje me:

Autobetoniere me kapacitet 2.5 - 3 m³ 2 cope

Këto mjete janë kërkuar për përgatitien dhe hedhjen e betonit në ato pjesë ku nuk mund të aksesojnë autobetonieret e mëdha, pasi përveç peneleve me gabiona do të kemi dhe sistemim përroi që vjen nga qyteti dhe derdhet në lumë, përrua i cili do të vishet me beton.

Në lidhje me:

Autobot uji 2 cope

Ky mjet është kërkuar për të bërë të mundur larjen e rrugëve dhe pastrimin që mos të ngrihen pluhurat gjatë punimeve, pasi zona që do punohet është pranë qendrës së banuar.

Gjithashtu duhet ujë për procese të ndryshme siç është lagia e betonit, ujitja e pemëve, pastrimi i gurëve, etj.

Në lidhje me:

Autoberoniore 4 cope

Autopompe betoni 2 cope

Referuar preventivit dhe manualit të çmimit kemi punime betoni:

Shtrese betoni C16/20 t=15cm

Nr	Emërtimi	Tipi	Njësia	Sasia
	manual			
√	Transport auto mbi 10 km	TRANSPORT	t/km	12.48
√	Vinc kulle 4-6 T me manovrator	MAKINERI DHE PAJISJE	cp	0.73
√	Beton C-16/20 (Me zall)	MATERIAL	m ³	1.04
√	SP+P (paga bruto + kontributet)	PUNTORI	op	8.6

Një nga zërat e përbërës të betonit është dhe Transporti i Betonit, dhe për të realizuar këtë transport nevojiten autobetonieret, ndërsa për hedhjen e betonit është e nevojshme Autopompa e betonit. Këto mjete janë dhe referuar analizës së çmimit të manualit teknik.

Në lidhje me:

RTV - Trasporter per mjete te renda 2 cope

Për të sjellë në objekt eskavatorë me zinxhirë dhe paisjet e ndryshme nevoiten RTV.

Në lidhje me:

Agregat per prerje bimesie 1 cope

Është kërkuar për të bërë pastrimin e përroit dhe rrugëve nga bimët e ndryshme, pemë që pengojnë punën etj.

Në lidhje me:

Moto gjenerator 2 cope

Këto paisje janë kërkuar për të bërë të mundur pasjen e energjisë elektrike për kryerjen e proceseve të ndryshme siç janë, vënia në punë e vibratorëve të betonit, motopompës ujit, kthyeses së hekurit, ndriçimin e objektit etj, pasi është objekt në lumë dhe s'ka pikë lidhje energjie.

Në lidhje me:

Betoniere kantieri 1 cope

Kjo paisje është kërkuar për të realizuar beton në ato pjesë të kanalit ku nuk futet autobetonieria e madhe, dhe autobetoniere 2.5 m³.

Në lidhje me:

Vibrues betoni 3 cope

Këto paisje kërkohen për vibrimin e betonit. Referuar dhe zbërthimit të analizave teknike të zërave në preventiv, të pranuar dhe nga vetë operatori ankimes rezulton se ky zë është i nevojshëm.

Në lidhje me:

Karroca dore 6

Këto paisje janë të nevojshme për transportin e materialeve të imta dhe të vogla në objekt, siç janë transport dërrasash, binarë, tel të xinguar për lidhjen e rrjetes së gabionave etj.

Në lidhje me:

Moto pompe uji 2 cope

Këto paisje janë kërkuar për marijen e ujit nga autoboti dhe nga depozitat dhe shtytjen e tij në distanca të largëta ku nuk shkon mjeti për të realizuar lagjen e betonit. Për këto arsye pretendimet e ankuesit nuk qëndrojnë.”, duke arsyetuar se këto mjete janë të nevojshme për realizimin e punimeve objekt prokurimi.

Komisioni referuar pretendimeve të ankimesit, argumentimeve të komisionit të shqyrtimit të ankesës, analizës teknike së zërave të punimeve objekt prokurimi, si dhe relacionit teknik të punimeve, gjykon se kërkesa për mjetet si në vijim: “*Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 10-12 t, Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës jo më të vogël 20 t, Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri në 1.5-3.5 t, Kamion me vinc, Eskavator me zinxhir me krah jo më pak se 18 m, Fadromë (mjet teknologjik me goma), Dumper (mjet teknologjik me goma), Grejder (mjet teknologjik me goma), Rul ngjeshës me vibrim mbi 15t, Autovinc, Autobetoniere me kapacitet 2.5 - 3 m3, Autobot uji, Autobetoniere, Autopompë Betoni, RTV - Transportier për mjete të rënda, Agregat për prerje bimësie, Moto gjenerator, Betoniere kantieri, Vibrues betoni, Karroca dore dhe Moto pompë uji”*, është një kërkesë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit të prokurimit, pasi referuar relacionit teknik të dokumentve të tenderit kërkesa për mjetet si në vijim: “*Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 10-12 t, Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës jo më të vogël 20 t, Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri në 1.5-3.5 t, Autobetoniere me kapacitet 2.5 - 3 m3, Autobot uji, Autobetoniere, Autopompë Betoni, Moto gjenerator, Betoniere kantieri dhe Karroca dore.*” është një kërkesë e domosdoshme për realizimin e zërave të preventivit sipas specifikimeve teknike dhe në përputhje me natyrën zërave të punimeve, si dhe të domosdoshëm për transportin e materialeve për realizimin e këtyre zërave në raport me terrenin e vështirë ku do të realizohen këto punime, ndërkohë që mjetet si në vijim: “*Agregat për prerje bimësie dhe Vibrues betoni*” janë të domosdoshëm për kryerjen e dis zërave të punimit referuar analizës teknike të këtyre zërave sipas përcaktimeve të VKM-së Nr. 216, datë 13.4.2023 “*Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim*”. Për më tepër, lidhur me numrin e këtyre mjeteve dhe konkretisht për mjetet si në vijim: “*Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës 10-12 t, Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës jo më të vogël 20 t, Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri në 1.5-3.5 t, Autobetoniere me kapacitet 2.5 - 3 m3, Autobot uji, Autobetoniere dhe Autopompë Betoni,*”, Komisioni gjykon se numri i këtyre mjeteve nuk është në porporcion me volumin e zërave të punimeve dhe me afatin e kryerjes së këtyre punimeve dhe për më tepër autoriteti kontraktor nuk ka arritur që të argumentojë teknikisht numrin e këtyre mjeteve sipas parashikimeve të lëgjislacionit për prokurimin publik.

Ndërsa lidhur me kërkesën për mjetet si në vijim: “*Kamion me vinc, Fadromë (mjet teknologjik me goma), Dumper (mjet teknologjik me goma), Grejder (mjet teknologjik me goma), Rul ngjeshës me vibrim mbi 15t, Autovinc, RTV - Trasportier për mjete të rënda.*”, Komisioni gjykon se është një kërkesë jo në përputhje me natyrën e punimeve objekt prokurimi dhe me relacionin teknik të kryerjes së këtyre punimeve, pasi referuar relacionit teknik të dokumentave të tenderit këto mjete nuk janë të nevojshme për kryerjen e zërave të punimit objekt prokurimi.

Përsa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.8 “*Aftësitë teknike dhe profesionale*”, të shtojcës 7 “*FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të tenderit të modifikuara, në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranohet pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “*B 93 IP*” ShPK për procedurën e prokurimit “*Ndërtimi i pritave në bregun e lumit Devoll, në kuadër të mbrojtjes së tokave bujqësore, Bashkia Gramsh*”, me fond limit 82,035,740 leke, pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 29.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Gramsh
2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “*B 93 IP*” ShPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar
Fiorent Zguro**

**Anëtar
Kreshnik Ternova**

**Anëtar
Gjergj Mersini**

**Kryetar
Jonaid Myzyri**